



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 6

Rrogozhinë, më 19.09.2023 ora 15 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Kryetares së Këshillit Bashkiak me Nr.3262.Prot datë 14.09.2023 si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.5, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 06.09.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënie autorizimi kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt : Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet bashkisë Rrogozhinë dhe Avokaturës së Shtetit për të autorizuar e legjitimuar Avokaturën e Shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të RSH”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për pagimin e shpenzimeve të varrimit”.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.77 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023”.
- 9- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin për servitut kalimi në pasurinë nr.1/187, zona kadastrale 3234, lagja nr.1, në Bashkinë Rrogozhinë” të kërkesës së z. Agron Aliu.
- 10- Shqyrtim i analizës së Realizimit të të ardhurave për 6-mujorin e parë 2023, ardhur nga drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.



- 11- Shqyrtim i Informacionit mbi punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve online, projekteve të reja, procesin e legalizimeve dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave ardhur nga Drejtoria e Politikave Urbane pranë Bashkisë Rrogozhinë
- 12- Informacion nga Drejtori e Bujqësisë, mbi punën e bërë dhe masat që do të merren në sistemin e kullimit për periudhën Shtator 2023-Mars 2024.
- 13- Informacion mbi punën e bërë nga sektori i pyjeve dhe përmirësimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.
- 14- Shqyrtim i kërkesës së ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a për dhënie opinionimi mbi propozimin për aplikimin e tarifave të reja në Bashkinë Rrogozhinë.
- 15- Të ndryshme.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Saimir Cani, Besnike Coraj, Sokol Gosa, Mitat Daja, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Renato Kalemi, Shpati Kolgega, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Bajazit Thaçi, Lije Dedej, Ferdi Avdiu, Fatbardha Sina, Fatmira Thartori.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës dhe Shërbimit Social.
3. Geraldo Gjini - Drejtor i Politikave Urbane.
4. Olsi Dranga - Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse.
5. Orges Tosku - Drejtor i të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
6. Andi Proshka - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
7. Besnik Dushku - Shefi i MZSH-s
8. Ledian Hasani - Përgjegjës i Shërbimit Social.
9. Luan Gjuzi - Përgjegjës i zyrës Juridike.
10. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të Pyjeve.
11. Dorina Shehi - Përgjegjëse e sektorit të Kadastrës.
12. Ismail Broli - Përgjegjës sektori i lejeve zhvillimore.
13. Mario Meka - Përgjegjës i zyrës IT.
14. Sidorela Troka - Specialiste Juriste.
15. Përfaqësues specialistë të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.



Drejtton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm gjithsej 15- Këshilltarë.

(Këshilltarja znj. Besnike Coraj i bashkohet mbledhjes 3 min pas fillimit të saj, duke e cuar në 16 numrin e këshilltarëve pjesëmarrës në mbledhje).

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë e kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët: z. Hekuran Xhani, znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, z. Saimir Cani, z. Sokol Gosa, z. Mitat Daja, z. Altin Tosku, znj. Gezime Met-hasani, z. Lulzim Hasa, znj. Alime Hoxha, z. Enver Memolla, z. Renato Kalemi, z. Shpati Kolgega, z. Erind Tosku, znj. Mukades Gixhari. Atëherë marrin pjesë në mbledhje gjithsej 14-Këshilltarë.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro, pika e parë e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.5, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 06.09.2023. E keni të gjithë përpara. Jeni dakord për miratimin e procesverbalit? E hedhim në votim. Pro, kundër? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën e tretë, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit social z. Ledian Hasani. Përshëndetje z. Ledian fjala për ju.



Ledian Hasani . Në total janë 15 familje me një fond prej 64 mijë lekësh.

Mitat Daja . Këto familjet e para janë që vijnë nga qeveria, sistem pikëzimi që janë në sistem? Ka një standart është vendosur standart.

Mukades Gixhari . E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro, pika 3 e rendit të ditës.

Vendim nr.17. Miratohet me 15 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3240.Prot datë 13.09.2023 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% “.

-Mbledhjes i bashkohet këshilltarja znj. Besnike Coraj në minutën e tretë të zhvillimit të mbledhjes.

Mukades Gixhari . Kalojmë ne pikën 4, Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor”. Përgjegjësi i sektorit z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Në total kemi 14-familje përfituese me një fond prej 54 mijë lekësh të reja.

Mitat Daja . Kam unë një ndërhyrje këtu tek kjo. Ndërhyrja nuk është për të bërë populizëm thjeshtë për të diskutuar. Njësitë Administrative kur paraqesin emrat për ndihmë ekonomike për personat që janë për t'u ndihmuar se nuk është ndonjë shumë e madhe, e kam thënë dhe herë tjetër shuma është Zot na ruaj por këto kanë të njëjtat kriteret siç ka vendosur qeveria apo thjeshtë bëjnë "qokat" nëpër njësitë administrative? Pyetje ka kriteret apo thjeshtë bëjmë "qoka"?

Ledian Hasani . Ka kriteret nuk bëhen qoka në zyrë, verifikohet familja merret dokumentacioni shikohet.

Mitat Daja . Kush e verifikon?

Ledian Hasani . Ka komision, komisioni që ju është paraqitur ju.

Mitat Daja . Nuk ka mundësi Ledo që të na paraqitet ndonjë fletë për kriteret që janë vendosur për këtë...?



Ledian Hasani . Po, ta paraqes unë.

Mitat Daja . Se shikoj njësia Gosë psh është mirë, paska goxha mirë.

Ledian Hasani . Sa ka Gosa?

Mitat Daja . 7 persona që janë në Gosë.

Ledian Hasani . Ku i sheh se po ngatërro projektvendimet?

Mitat Daja . Tek i dyti jo i pari.

Ledian Hasani . Po por atë që po lexon e ke kaluar e ke votuar.

Mitat Daja . Kush është pikëzimi?

Ledian Hasani . Nuk e di çfarë po lexon ti që të...

Mitat Daja . Atëherë thotë, "Për dhenien e ndihmës ekonomike për familjet ne nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi bllok i ndihmës 6%".

Ledian Hasani . Ato janë me pikëzim nga ministria.

Mitat Daja . Janë me pikëzim janë standarte...

Ledian Hasani . Pak a shumë i zgjedhin ato shumicën e emrave pothuajse, i ke të kufizuara sepse kriteret që kanë vendosur aty, e para duhet të aplikosh tek ndihma ekonomike dhe kanë disa kriteret ato që i kanë përjashtuar që i kanë futur tek kjo lista nuk ka këtu as për "qokë" as për gjë nuk e di pse... pse ka 7 familje? Normalisht keto 7 familje janë në gjendje të vështirë ekonomike këto të Gosës.

Mitat Daja . Pyetje bëra nuk akuzova.

Ledian Hasani . Edhe unë ju përgjigja.

Mitat Daja . Dakord përgjigje mora dhe kaq. Po për këtë ndihmën...?

Ledian Hasani . Çfarë problemi ka? Ato kanë aplikuar tek ndihma ekonomike janë kualifikuar



për një kriter herën tjetër mund ta ketë dhe Rrogozhina një listë ose mund ta ketë dhe Gosa.
Mitat Daja . Po tek lista e dytë për sa kohë mund ta përfitojë ndihmën ekonomike?

Ledian Hasani . Nga tre muaj edhe këshilli që ka qenë herë tjetër nga tre muaj i kemi lënë.

Mitat Daja . Se i bie kshu tani tre muaj kanë nevojë tre muaj tjera nuk kanë nevojë.

Ledian Hasani . Ka shumë nevojtarë.

Mitat Daja . Në qoftë se ka shumë nevojtarë pse nuk zgjerohet ajo... të jetë...

Ledian Hasani . Duhet parashikuar fondet për buxhetin e 2024, parashikojmë të ardhurat...

Mitat Daja . Se në qoftë se ka nevojtarë nuk janë vetë për tre muaj janë gjithë vitin. Dhe kjo ndihmë ekonomike që jepet nuk është ndonjë gjë që i zgjidh hallin atyre. Them që është një gjë ose janë nevojtarë ose janë herë pas here nevojtarë. Nuk është se jnë ditur nevojtarë, prandaj në qoftë se ashtu ka hapësira që mund të bëhet të bëhet ose të shikohet nuk e di si e keni ju sektori juaj mundësinë për të bashkëpunuar më zyra të tjera, zyra punësimi, zyra të tjera. Që këto njerëz që nuk e kanë e marin një herë në tre muaj të shikohet mundësia e punësimit, të gjendet mundësia e punësimit nuk e di se sa e keni realizuar ju bashkëpunimin me zyrat e tjera ose me institucionet e tjera të bashkisë dikush duhet të ma shpjegojë që këta njerëz që janë nuk kanë mundësi të punojnë dhe sa e kanë i ka ofruar zyra e ndihmës ekonomike mundësi punësimi këtyre. Me 30 mijë lekë nuk ia dalin si për njësitë edhe për qytetin. Ka ndonjë bashkëpunim të tillë?

Mukades Gixhari . Drejtori i financës do të përgjigjet për këtë.

Rezart Vogli. Përshëndetje të gjithëve, uroj të jeni mirë! Si drejtor i shërbimit social për rastet e familjeve që janë në skemë e ndihmës ekonomike në bashkëpunim me zyrën e punës në këtë moment që flasim bashkë janë thirrur të paktën të gjithë personat nga 2 herë. I ofrohet mundësia e punësimit se në bashkinë e Rrogozhinës nga Lekaj janë mbi 30 vende të lira pune, jane ftuar të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike i është ofruar punë aty ku e shohin të arsyeshme dhe presim.

Mitat Daja . Ndërhyrja ishte për të sqaruar sepse ndonjëherë... mbledhjen tjetër të këshillit thatë do kalojmë vetëm ndihmat... unë do propozoja nëse flitet për ndihmë ekonomike nëse do merrej mendimi im nëse është e lejuar ndihma ekonomike dhe ajo që futëm aty se ajo që ka futur emrin për të kërkuar ndihmë sigurisht që është në nevojë. Të kalohet në mënyrë automatike mos të



diskutohet më 100 herë nëse do ishte e lejuar 21 vota sa janë ta kalojmë ndihmën ekonomike sepse nuk është problem ndihma ekonomike, problemi është që çfarë kriteresh ndiqen për të vënë në punë dhe çfarë synohet me arritur tek puna nuk është thjesht t'i japësh as kafshatën e bukës. Dhe për sa i përket përfundimit pastaj u tha: jo se ndihmën ekonomike nuk e ndalojmë... nuk ka ndërmend ta ndalojë njeri ndihmën ekonomike. Unë jam i gatshëm nëse zyra e financës së bashkisë gjen mundësinë që atë që unë paguhem si këshilltarë të ja jap një familjeje në nevojë nuk ka problem të ja kalojë për 4 vjet sa do jem unë e kaloj një familje jo gjysmën sa është bonusi i këshilltarit ta kaloj një familje. Dhe këtë ta shikojë zyra e bashkisë. Unë i propozoj një familje ato e kalojnë në mënyrë automatike ose nuk e di si funksionon kjo punë e zgjidhni... por se duhen shikuar gjërat mirë, duhen kontrolluar gjërat mirë dhe duhen objektiva të qarta që njerëzit mos i mbajmë tre muaj dhe pastaj pas tre muajve ndërrojmë mendje se nuk kanë nevojë. Ato që janë të nevojshëm janë të nevojshëm përherë dhe ato qëndrojnë përherë ato që nuk janë të nevojshëm s'kanë pse të jenë në skemë të vazhdojnë punën dhe të gjendet mundësi punësimi me dëshirë edhe ndoshta ndonjë imponim si t'i vijë puna. Mos bëhet më ndihma ekonomike objekt bisede disa marrin flamurin e humanizmit duke thënë që ne do ndalojmë ndihmën ekonomike nuk ka ndërmend njeri të ndalojë ndihmën ekonomike.

Mukades Gixhari . Faleminderit z. Mitat. Pyetje tjetër? E hedhim në votim. Pro kundër abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 16-vota pro, pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr.18. Miratohet me 16-vota pro, projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.3242.Prot datë 13.09.2023, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor“.

Mukades Gixhari . Të nderuar këshilltarë ju bëj me dije që mbledhjes ju bashkua këshilltarjë Besnike Coraj. Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt-vendimit, “Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat”. Fjala për përgjegjësin e zyrës juridike z. Luan Gjuzi. Po fjala për ju, ta dëgjojmë pak z. Luan Gjuzi.

Luan Gjuzi . Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 70 për zgjedhjen e kryesisë të fshatit. Kryesia e fshatit zgjidhet një herë në 4-vjet, menaxhimi mbikqyrja e mbledhjes bëhet nga anëtarët e këshillit. Kërkojmë që të miratoni përfaësuesit e juaj që do jenë në mbledhje dhe kryesinë e fshatrave sipas propozimit tonë 3-5 anëtarë sipas...

Mitat Daja . Po mirë se aty ka një kriter po kur nuk mblidhet më shumë se gjysma e fshatit, si i bëhet për të zgjedhur?



Luan Gjuzi . Ato janë procedura që do të mbikqyren vetëm nga ju.

Mitat Daja . Këshilli ka rol mbikqyrës?

Luan Gjuzi . Po.

Mukades Gixhari . Do zgjedhim komisionet. Kryetarët e grupeve do fillojmë propozimin se me sa anëtarë do i bëjmë komisionet? Kryetari i grupit z. Enver Memolla.

Enver Memolla . Në emër të grupit parlamentar (grupit të këshillit) të partisë socialiste, unë propozoj që çdo komision të ketë tre anëtarë. Dy anëtarë shumica parlamentare (e këshillit) e pozitës dhe një opozita.

Indrit Dedej . Jemi dakord me Verin të jetë me tre anëtarë nuk na prish punë të njoftohen njerëzit dhe aq.

Enver MemollaÇdo komision firmos procesverbalin në fund.

Mukades Gixhari . Kalojmë tek propozimi i emrave të këshilltarëve që do jenë pjesë e komisioneve.

Enver Memolla . Atëherë meqenëse jam kryetari i grupit të PS maxhorancës filloj propozimin nga njësia administrative Sinaballaj.

Hekuran Xhani . Me leje kryetare, sa për procedurë dhe sqarim është mirë anëtarët e këshillit përfaqësues të njësisë administrative, të jenë edhe përfaqësues të zgjedhjeve në zonë.

Enver Memolla . Patjetër.

Hekuran Xhani . Të njohin fshatin të njohin terrenin, pra mos propozojmë dikë nga Rrogozhina.

Mukades Gixhari . Fillojmë me Sinaballaj. Vazhdojmë z. Enver.

Enver Memolla . Gezime Met-hasani. Altin Tosku.

Mukades Gixhari . Z. Indrit?

Indrit Dedej . Do shkoj vetë.



Mukades Gixhari . Në Gosë?

Enver Memolla . Atëherë Njësia Administrative Gosë. Fatmira Thartori anëtare e këshillit të PS komuna dhe Njësia Gosë dhe Alime Hoxha.

Indrit Dedej . Unë propozoj Besnike Coraj.

Mukades Gixhari . Vazhdojmë me Lekajn.

Enver Memolla . Mukades Gixhari, Shpati Kolgega.

Indrit Dedej . Hekuran Xhani.

Mukades Gixhari . Kemi Kryevidhin.

Enver Memolla . Atëherë Kryevidh z. Lulzim Hasa, banues në Njësinë Kryevidh, Erind Tosku.

Indrit Dedej . Bajazit Thaçi.

Mukades Gixhari . Tani meqë pozicionet i zgjedhëm tani kemi edhe fillimin dhe mbarimin e procesit zgjedhor, që fillon nga data 20 Shtator deri 30.

Enver Memolla . Pa ardhur vendimi i Prefekturës nuk procedojmë, data 20 bie poshtë.

Lulzim Hasa . Në momentin që vjen konfirmimi mbledhemi .

Hekuran Xhani . Ne i kemi miratuar në parim, ditën që vjen konfirmimi nga Prefektura, për të mos i vënë këshillit detyrim mbledhje prap...

Enver Memolla . Kryetare ta lejmë nga dita e miratimit nga Prefektura vejmë një datë mbrapa.

Mukades Gixhari . Mbrapa 10 Tetorit, ta kemi përfunduar.

Enver Memolla . Pas miratimit na sillni vendimin që të bëjmë grafikët nëpër zona që anëtarët e këshillit të bëjnë...

Mukades Gixhari . Atëherë 10 Tetor është data e fundit. Atëherë e hedhim në votim komisionet që sapo i zgjedhëm, "Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjejn e strukturave komunitare në fshat". Pro, Kundër, Abstenim? Mitati?



Mitat Daja . Abstenim.

Mukades Gixhari . Atëherë 1 (një) abstenim të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro,1-abstenim, 0-kundër, pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.19. Miratohet me 15-vota pro,1-abstenim, 0-kundër, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3060.Prot datë 31.08.2023 “Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e strukturave komunitare në fshat “, plotësuar sipas propozimeve të bëra nga këshilltarët për komisionet me tre anëtarë që do mbikqyrin procesin zgjedhor të strukturave komunitare nëpër fshatra, si dhe data e fillimit të procesit zgjedhor që nis nga mbërritja e "Verifikimit Ligjor" të këtij vendimi nga ana e Prefektit të Qarkut deri me dtaën 10 Tetor 2023.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 6-të . Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënie autorizimi kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt : Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet bashkisë Rrogozhinë dhe Avokaturës së Shtetit për të autorizuar e legjitimuar Avokaturën e Shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të RSH”. Fjala për përgjegjësin e zyrës Juridike përsëri z. Luan Gjuzi. Luan Gjuzi fjala për ju.

Luan Gjuzi . Avokatura e shtetit si institucion ka një çështje gjyqësore dhe i ka bërë bashkisë Rrogozhinë një kërkesë për ti dhënë kompetencat dhe gjykatë për të bërë rekurs në mbrojtjen e bashkisë Rrogozhinë, pasi ne si bashki Rrogozhinë nuk kemi mundësi jo nuk kemi mundësi por nuk kemi të ardhura që të hartojmë ose të nënshkruajmë rekurs ose të përfaqsojë bashkia Rrogozhinës se nuk kemi licencën e avokatit. Ato duan një licencë 10 vjecare dhe asnjë nga ne nuk e ka në Rrogozhinë prandaj kërkojmë që këtë kopetencë të ja japim avokaturës së shtetit,kërkesën e ka bërë vetë avokatura e shtetit.

Mitat Daja. Dëgjoni dhe këto tjerët dëgjo se në momentin që dëgjojnë se kërkohet nga bashkia do të ngrenë dorën ska nevojë për diskutime më shumë.Ta hedhim votim direkt se gati janë të gjithë, pa e ditur ca bëhet.

Mukades Gixhari. Ndonjë pyetje? E hedhim në votim Pro Kundra abstenim? Të gjithë pro miratohet.

-Miratohet me 16-vota pro,0-abstenim, 0-kundër, pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr.20. Miratohet me 16 vota pro, projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë me



shkresë Nr.2903.Prot datë 23.08.2023 “Për dhënie autorizimi Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë me objekt: Hartimin, nënshkrimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Bashkisë Rrogozhinë dhe avokaturës së shtetit për të autorizuar e legjitimuar avokaturën e shtetit për të nënshkruar, depozituar rekursin për ta përfaqësuar Bashkinë Rrogozhinë në Gjykatën e Lartë të Rsh“.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën 7 (shtatë) Miratim i projekt-vendimit, “Për pagimin e shpenzimeve të varrimit”. Fjala për drejtorin e financës zotin Rezart Vogli.

Rezart Vogli. Si përgjegjës i pozicionit janë depozituar dy shkresa ndërhyrja nga andikatori i shpisë 12 veta ku na kërkohet mbështetja dhe financimi i shpenzimeve funerale një në fshatin Luz i Madh dhe një në fshatin Mushnikë. Është kërkesa e bazuar nga ana e indikatorit, krahas saj para dy mbledhjesh me këshillin bashkiak u diskutua për një mbështetje financiare të zonjës Liliana Danushi e cila ndërroi jetë më datë 28 .08.2023 ishim gati në këshill për miratimin e atij fondi prej 88 lekësh mqs e ndjera ndërroi jetë fondi ta mari dikush tjetër. Familjari shpreh dëshirën dhe i drejtohet këshillit bashkiak të bashkisë Rrogozhinë që atë ndihmë nëse është e mundur ka me qenë kontributi për keto shërbimet funerale. Të tre projektvendimet kanë të bëjnë me shërbimet funerale zonja Liliana Danushi banuese e Rrogozhinës dhe dy zonjat e tjera banuese të fshatit Mushnikë nuk është se kam shumë informacion. Nëse këshilltarët kanë informacion të na ndihmojnë që të jemi të qartë edhe ne pastaj...

Mukades Gixhari.Zoti Hekuran?

Hekuran Xhani. Përsa i përket shpenzimeve të varrimit për dy viktimat,qofshin të xhenetit në qoftë se është në rregull le ti jepet ky shpenzim funerali për arsye ekonomik,biles njëra ajo e Luzit ka qenë e vetme,jetonte vetëm dhe vdekja e saj u zbulua 3-4 ditë me vonesë dhe unë jam dakort për të treja...

Mukades Gixhari. Ta hedhim në votim Pro, Kundra, Abstenim, Miratohet.

-Miratohet me 16-vota pro,0-abstenim, 0-kundër, pika 7 (shtatë) e rendit të ditës.

Vendim nr.21. Miratohet me 16 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3129.Prot datë 06.09.2023 “Për pagimin e shpenzimeve të varrimit”.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën 8(*tetë*). Miratim i projekt-vendimit, “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.77 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023’”. Shefi i MZSH-s zoti Besnik Dushku. Përshëndetje zoti Besnik!

Besnik Dushku. Në lidhje me kërkesën që ka bërë këshilli jemi bazuar në ligjet dhe nenet.

-11-

Paraprakisht po ju njoh se c është shërbimi zjarrfikës dhe misionet i parë i shërbimit zjarrfikës. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shërbimi i MZSH-s është për kohë e specializuar e bashkisë



së rrethit, cdo fjalë ka kërkimet e veta. Misioni i shërbimit zjarrfikës i bashkisë tonë është i njëjtë me të gjithë shërbimet zjarrfikëse të Republikës së Shqipërisë, nuk ka mision për mos shpëtimin e jetës së njerëzve, pronës pasurisë nga zjarret, përmbytjet aksidentet e ndryshme, fatkeqsitë e ndryshme natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut. Për përmbushjen e këtij misioni premtohet mirëkompletimi organik nga linja largimi i efektivit gjithashtu kërkohet kompletimi me mjetet dhe pajisjet e duhura për të ndërhyrë në një situatë që ka zjarr, përmbytje, aksidentë të ndryshme apo fatkeqësi natyrore. Ju bëj me dije se përsa i përket kompletimit me mjete apo pajisje falë përkushtimit të kryetarit të bashkisë, jemi kompletuar me mjete dhe pajisje në rast aksidenti sepse mund të them që jemi stacioni i fundit, nga më të fundit që kemi filluar në Shqipëri në ndërtim të kompletimit të mjeteve dhe të pajisjeve përkatëse kemi ecur goxha mirë. Mjetet e ndërhyrjes së aksidentit kur ne shkojmë nga afër dhe jo të rrimë si kemi pas ndenjur në aksidente dhe shikojmë motrën, vëllain, nënën që po jepte shpirt dhe smundenim dot me e ndihmuar. Tani efektivit shkon direkt dhe realizon operacionin e ndërhyrjes tjetër vjen për të përmendur raste të tjera e kemi dhe paraqitjen është zbatimi e VKM nr.1153 më datë 24.4.2020 është kompletimi me uniformat sipas standarteve të planifikimit të MZSH-s. Paraprakisht dua të ju njoh me organikën e shërbimeve zjarrfikës në bashkinë tonë. Shërbimi zjarrfikës i bashkisë tonë ka një efektiv prej 14 vetësh që realizojnë ndërhyrjen, dy niveli i mesëm shef stacioni, drejtuesi i shuarjes së zjarrit dhe 12 niveli bazë. Këta të nivelit bazë janë komandant shërbimesh 4, drejtues shërbimesh 4 dhe zjarrfikës të nivelit bazë. Kjo organikë është bazuar në pikën 6 të nenit 7 252/2015 që është ligji për shërbimim të mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, është bazuar edhe në pikën 12 të nenit 16 të VKM 520 datë 25.07.2019 për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi. Ky është standarti më minimal mbi funksionimit të një stacioni zjarrfikës por në pikën 12 të nenit 16 theksohet se organizimi i shërbimeve zjarrfikës do të bëhet jo me më pak se tre punonjës. Zonja kryetare, zonja dhe zotërinj ju bëj me dije se vendimi i punës së shërbimit zjarrfikës bëhet sipas nenit 33 të VKM 520 të datës 25.07 i Rregullores dhe shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi dhe ne nuk mundemi dot të luajmë. Punonjësi i nivelit bazë të OTR vijë pranë degës me një sistem 24 orësh, shërbim pa ndërprerje dhe staf pa ndërprerje në kushte normale dhe në rast se do të kemi zjarre përmbytje apo aksidente do të paraqitet menjëherë grupi në dispozicion. Në rast se ka problematika me miratim të kryetarit paraqitet i gjithë grupi. Në nenin 30 të ligjit 152 2015 që është ligji i kushtetutës së mbrojtjes nga zjarri MZSH-s për efektivin shprehet se koha e punës dhe pushimit për punonjësin e shërbimit të MZSH-s mësohet edhe nga punonjësit e tjerë të administratës shtetërore përveç kur parashikohen ndryshime në këtë drejtim. Pushimi vjetor për punonjësit me gradë është 28-40 ditë që është i ndarë sipas vjetërsisë dhe gradave, gjë të cilën deri tani ne nuk e kemi zbatuar nuk i kemi dhënë leje punonjësve të nivelit bazë pasi ti jepnim leje preknim pikën 12 të nenit 16 të VKM 520. Nuk mund të linim punën me dy veta prandaj mesa ju thash me lart i jam drejtuar të gjithë shkallëve që më ka lejuar dhe adresuar ligji që të zbatohet nenin 9. Neni 9 për kryetarin e bashkisë thotë shprehimisht: Mer masat për ngrijtjen dhe kompletimin me mjetet dhe pajisjet të stacionit me mjetet e shpëtimit të shërbimit MZSH-s në territorin e bashkisë sipas standarteve dhe normave në fuqi. Planifikon fondet e shërbimit të



MZSH-s nga buxheti i bashkisë për cdo vit dhe kryetari i bashkisë siguron gatishmërinë e menjëhershme të shërbimit zjarrfikës me ato mjetet e pajisje special, personel zjarrfikës për të cilën i vë ato në dispozicion për shuarjen e zjarreve shpëtimin e jetës, pronës në cdo rast aksidenti incidenti fatkeqsi apo emergjenca të ndryshme në sektorin e bashkisë. Përsa i përket zbatimit të nenit 30 të pikës dhe VKM 203 ju bëj me dije se orët e punës që kryhen nga efektiv i MZSH-s në bashkinë tonë 365 ditë herë 3/4 që është një turn herë 24 orë bëjnë 26 mijë e 280 orë punë në gadishmëri. Në bazë të VKM 213.4.2019 mesatarja mujore për një efektiv të nivelit bazë është 174 orë pune mujore, 11 muaj se një muaj duhet leja herë 174 i shkojnë 1914 orë pune që duhet të bëjë një zjarrfikës i nivelit bazë për një vit, herë 12 vetë që është efektiv jonë shkojnë 22 mijë e 968 pa hequr ditët e festave. Sipas asaj që ju thashë më lart efektiv bën 26 mijë e 280 orë pune duke u nisur nga këta kemi 4 mijë e 4 qind e 64 orë pune tepër pa patur situata ndërhyrje, gadishmërie dhënie ndihmas etj. Po të nisim zonja kryetare dhe anëtarë të këshillit në faqen 3 ligjin që kemi që duhet të zbatohet një zjarrfikës profesionisht duhet të jetë 1500-2000 punonjës 2 mijë qytetarë të një bashkie dhe na takon 20 zjarrfikës e mos me thënë 21. Në pamundësi të kompletimit me 20 zjarrfikës, unë kam kërkuar në minimumin 3 efektiv që ti jap lejen e zakonshme dhe pushimeve të efektivit. Që të jemi të shkresa që jeni drejtuar me rradhë kemi njësi të mesme, ministrisë së financës kryetarit edhe ju 10 që deri tani nuk është hedhur për diskutim. Në qoftë se është dicka që nuk është në bazë të ligjit jemi këtu për diskutim.

Mukades Gixhari. Po, zoti Sokol Gosa?

Sokol Gosa. E kam lexuar me shumë vëmendje të gjithë materialin e paraqitur dhe mendoj se jo 3 që është bërë propozimi nga përgjegjësi por për mua të shkoj numri edhe 20, nisem edhe vetë nga situata që sapo kaluam e zjarreve që ra edhe në Sinaballaj apo nga zona të tjera apo në aksidente të ndryshme që kanë ndodhur ndërhyrja e tyre dhe ky numër kaq i kufizuar prej 14 personash që kanë qenë deri tani nuk kuptoj pse ky numër nuk është shtuar përgjegjës para 2, 3, 5 vjetësh ku qëndronte problemi, ngërçi që ...?

Besnik Dushku. Është e paraqitur tek ky neni që ju thashë unë që ndihmon që është e drejta dhe përgjësitet që ka kryetari i bashkisë dhe vjet kam qenë prap në strukturë ia kemi kërkuar prap dhe ska pas...

Sokol Gosa. Për mua prap ajo jo 3 por edhe 20 sepse me këto kushte që po përballemi për mua kjo gjë është domosdoshmëri.

Mukades Gixhari. Po, zoti Erindi?

Erind Tosku. Unë jam me të njëjtin mendim si Sokoli sepse me të vërtetë ato kanë dhënë goxha kontribut për zjarret që kanë qenë të paktën në bashkinë tonë apo në bashkitë e tjera ku ka patur



nevojë dhe relativisht është dicka që jo...që zjarrëfiksi të mos ketë mundësi të pushojë të larg fëmijëve në një festë,gëzim apo hidhërim kështu që për buxhetin e 2023 kur kemi patur mundësi të shtojmë më shumë ose më pak nqs kemi mundësi dhe për këtë mund të na japi përgjigje shefi i financave për 3 punonjësit të shtohen dhe në buxhetin e 2024 nëse kemi mundësi për të arritur më shumë sepse është me të vërtete e nevojshme për komunitetin tonë dhe për fqinjët që kemi rreth e përqark Kavajë,Peqinin,Lushnjen dhe gjithë të tjerat që do të kenë nevojë.

Mukades Gixhari. Po,zoti Mitat Daja?

Mitat Daja. Bes, sa zjarrfikëse ka gjithsej stacioni Rrogozhinë? Sa?

Besnik Dushku. Dy zjarrfikëse.

Mitat Daja. Të dyja janë në gjëndje pune, punojnë nuk kanë probleme domethënë këto funksionojnë në qoftë se do të ketë zjarr këto do funksionojnë të dyja?

Besnik Dushku. Po,po njëra është në gadishmëri dhe njëra në turn.

Mitat Daja. Po pra,e kuptova.

Besnik Dushku. Me fqinjët kemi marrëdhënie shumë të mira kur ndodhi në Ballaj ishte prezent edhe kur erdhi Kavaja dhe Peqini por që kemi shkuar edhe ne si Peqinit dhe Kavajës...

Mitat Daja. Po mirë pse bashkia nuk e ka vlerësuar jetën e njerëzve kaq shumë që ka lënë pas dore stacione zjarrfikësve sepse unë nuk di të ketë gjë më të shtrejtë në botë sesa jeta e njerëzve, ju i qenkeni lutur kaq herë këshillit bashkiak apo ka patur probleme të tjera me listat e tërmeteve prandaj s ka patur kohë të merret me zjarrfiksin përderisa e keni paraqitur kërkesën disa herë ato skanë patur kohë ta diskutojnë përderisa bashkia ka bërë një kërkesë të tillë drejtori i financave nuk ka ndonjë vlerësim për këtë kërkesë dhe pse 3 pse të mos bëhet 5,pse të mos bëhet numri maksimal se kjo është shkurto diku tjetër dhe ato që kanë një profesion të bankomatit...

Besnik Dushku. Në theksim të vlerësimit me ardhjen e këtij kryetarit zjarrfiksit kanë marrë edhe sekondin e fundit të pagesës, nuk ka zjarrfikës që nuk përballohet puna me numër prandaj i kërkoj këta ndërsa në drejtim të vlerësimit se të gjithë vijnë për punë...

Mitat Daja. Nuk e thashë për atë, vlerësimin e plotë, thash për vlerësimin e shtesës.



Besnik Dushku. Kemi qenë në Zambishë para 2 vjetësh 3 ditë e dy netë na u plas buza dhe skemi marrë lekët, por ka dy vjet që janë paguar sekond sekond, dhe në qoftë se i kam hyrë në hak ndonjërit unë...

Mitat Daja. Flas për shtim personeli.

Mukades Gixhari. Po, zoti Enver Memolla cfarë mendimi keni?

Mitat Daja. Flas për shtim personeli pse të mos bëhet personel i plotë jo 17 (shtatëmbëdhjetë) të bëhet 20 (njëzet).

Besnik Dushku. 20 (njëzet)? Unë ku ta gjej.

Mitat Daja. Shkurtohet ja ku është, drejtori i financës duhet të na japë përgjigje fikse...

Besnik Dushku. Ne ku ta gjejmë por po flasim për minimumin.

Mitat Daja. Drejtori i financës mund të na japi përgjigje për këtë.

Hekuran Xhani. Ne mund ta bëjmë edhe 30 (tridhjetë) por varet sa mundësi financiare ka bashkia.

Mitat Daja. Ngelët duke qajtur për mundësitë financiare, këtu mblidhen taksa këtu ka punë të tjera, cpunë kemi me mundësitë financiare drejtori i financës të na e thotë? Drejtori i financës i vendos mundësitë financiare po bëjmë sikur po qajmë vetëm hallet.

Mukades Gixhari. Po zoti Enver.

Enver Memolla. Faleminderit zonja kryetare, duke marrë shkas nga debati duhet të dimë që problematikat janë të mbartura nuk ka lindur sot apo dje apo do të vijnë nesër. Përsa i përket drejtorisë zjarrfikse bashkia financiare para një viti, dy vitesh dhe këtë vit me të vërtet që ne por duhet të dini dicka që organika duke i kthyer përgjigje edhe zotit Mitat nuk vendoset nga bashkia Rrogozhinë por nga Ministria e Brendshme mos gabohem zoti Besnik?

Besnik Dushku. Jo në lidhje me.. ne jemi me dy varësi,nenin 9 mund ta gjeni këtu,por kalon me kopetencë dhe kompletimit me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës i kalon edhe kryetarit të bashkisë është tek neni 9 ligji 152 ligjerimi 115 që është ligji i shërbit të mbrojtjes nga zjarri, por mora tre pika që ishin më të domosdoshme i ke të përcaktuar.



Enver Memolla. Atëherë për të vazhduar mbledhet dje komisioni i ekonomisë ku një anëtarë i saj sot mungon ne bëmë një propozime që vetëm punësime që ka bashkia Rrogozhinë si në buxhet si në prona na duhet një stacion tjetër zjarrfiksi në zonën e Kryevidhit që kap Vilën, Spillen.

Besnik Dushku. Kjo kap pjesën e poshtme dhe arrin aty ku tha Mitati dhe shkon 20 që një zjarrfikëse zgjidh shumë punë më një orar të përcaktur 10 me 10 dhe kjo gjë bëhet me miratim të kryetarit e ka ligji.

Enver Memolla. Atëherë struktura juaj a mund të zgjerohet me kërkesë nga ministria e brendshme?

Besnik Dushku. Duhet që ministria ti drejtohet ministrisë së financës e kjo jetojmë në Shqipëri, Kamza e ka cuar më shumë se sa stacione dhe i ka marrë po nga ministria e financës, ne ministria e financës na coi tek ligji nuk na dha fond. Edhe zjarrfikësja që është marrë atëherë është marrë bashkie tjetër, është marrë fondi i tjetër bashkie.

Enver Memolla. Atëherë unë kam një sugjerim përse i përket drejtorisë së financave dhe taksave që në momentin që do të sjellin propozimin për buxhetin ju lutem që pjesën e zjarrfikësve ta keni përparësi si për pjesën e shtimit të strukturës që paguhet nga buxheti i bashkisë Rrogozhinë dhe në pjesë të ardhurash nëse është e mundur me të vërtetë kjo pjesë ndërkohë që të keni në fokus uljen e nevojshme të bashkisë Rrogozhinë. Po flasim për pranë komisionin të ekonomisë që ka një lidhje të fortë me pjesën e borxheve por realisht pjesa e zjarrfikësës është shumë e ndjeshme sidomos ku ka të bëjë me pjesën e jetëve të njerëzve po me publikun. Realisht ka të bëjë edhe pjesa e njerëzve si të them edhe logjika e njerëzve është e dobët por pa dashje bie zjarr por përgjësia është e madhe. Edhe zjarrfikësit se ka edhe kshu edhe kshu dhe ata njerëz janë, unë i kam parë me sytë e mi që marin pompën në krahë si bënë atë ditë Zhamë që shkuan dhe shpëtuan familjen. Ndaj Rez këtë pjesë, të jetë një rënie në pjesën e buxhetit kur të sjellësh Komisionit të Ekonomisë realisht atyre i duhet edhe stacion edhe punonjës por edhe mjete të tjera.

Indrit Dedei. Tani ti do stacion apo punonjës? Stacion do të kesh edhe makinë, e ke parasysh...

Besnik Dushku. Makina kemi.

Indrit Dedei. Në qoftë se do stacion...

Besnik Dushku. Për stacioni ka shumë nevojë se stacioni ka standarte në drejtin të ngrijtjes sikurse duhet. Është gjesë e madhe ajo për ngrijtjen e një stacioni sipas standarteve.



Indrit Dedei. Tre punonjës nuk është e vështirë, të ngrish atë është e vështirë atëherë kalojmë tre punonjës...

Besnik Dushku. Të jepni maksimumi gjashtë dhe të mbledhim pikë edhe për furnizuesit edhe evakusit i kemi...

Mitat Daja. Pse mos kemi maksimumin ky është problemi Rez na jep një përgjigje, a është mundësia ...

Mukades Gixhari. Do ta shpjegojë me hollësi këtë që sapo...

Mukades Gixhari. Zoti Rezarti?

Mitat Daja. A është mundësia?

Rezart Vogli. Ta vazhdoj aty ku e la edhe shefi i MZSH-s me raportin e fundit që la KLSH i cili është institucioni që auditon cdo institucion varësie ndër të tjera është kërkuar që stafi zjarrfikës përball ose cdo staf zjarrfikës 1500-2000 banorë. Aktualisht janë 14 (katërbëdhjetë), 2 (dy) drejtues dhe 12 (dymbëdhjetë) duke qenë se jemi edhe në fund të vitit dhe tre muaj na ndajnë nga viti pasardhës, nga muaji Tetor - Dhjetor duhet të diskutojmë cdo kërkesë buxhetore, cdo hall, cdo shqetsim që do të ketë cdo lloj drejtorie, institucioni varësie i bashkisë ndër të tjera do diskutohet mbi stafin shtesë zjarrfikës për vitin pasardhës. Aktualisht po flasim nga muaji Tetor-Dhjetor, ky staf zjarrfikës po kërkohet për këto tre muaj që të mbylлим lidhjen brenda.

Mitat Daja. Kjo do të jetë vetëm për tre muaj apo përherë?

Rezart Vogli. Buxheti i vitit 2024 do diskutojmë cdo kërkesë që do të ketë cdo lloj drejtorie, do diskutohet në komisionet përkatëse të këshillit bashkiak dhe do të shikohen, shqyrtohen dhe nëse është e mundur pse jo?

Mitat Daja. Duhet shikuar me përparësi kjo gjë.

Enver Memolla. Ky është ndryshim projekt-vendimi që ndryshon zërin e shpenzimeve tuaja.

Rezart Vogli. Referuar për cdo orë pune që stafi zjarrfikës ka ushtruar si brenda edhe jashtë bashkisë Rrogozhinë sic tha dhe shefi i zjarrfikësit janë paguar financiarisht për cdo orë.

Mitat Daja. Tha ai, në rregull



Rezart Vogli. Gjatë vitit janë kompletuar si tha dhe shefi i MZSH-s me mjete, me pajisje, me uniforma dy zjarrfikëse janë vënë në gjëndje pune. Buxheti për zjarrfikësen i kalon kërkesat domethënë ka plus nga ana e bashkisë Rrogozhinë. Aktualisht jemi për të miratuar një projekt vendim për ndryshime buxhetore që prekin sistemin zjarrfikës për këta punonjës dhe efektet financiare që rrjedhin nga ky ndryshim janë 544 mijë e 5 qind lekë. Janë parashikuar nga fondi rezervë i buxhetit bashkisë Rrogozhinë i cili është masën 3 përqind buxheti total, është zë që është parashikuar në buxhet pikërisht për këto ndryshimet buxhetore që mund të bëhen gjatë vitit. Kërkojmë që ta heqim aty ku është nga aparati fondi rezervë ta kalojmë tek zjarrfikësja për paga dhe sigurime shoqërore as për gjë tjetër. Që stafi i tyre të rritet me tre punonjës të tjerë për tre muajt pasardhës.

Mitat Daja. Për këto tre muajt do të rriten tre punonjës?

Rezart Vogli. Po, nuk mund të flasim për muajt pasardhës në muajt që jemi aktualisht.

Mitat Daja. Nuk është e mundur që të bëhet këto tre mujor?

Rezart Vogli. Si?

Mitat Daja. Nuk është e mundur që të bëhet këto tre mujor?

Altin Tosku. Jo është fondi, është fondi shtesë.

Enver Memolla. Ky fond ndryshon pjesën e shpenzimeve të bashkisë.

Hekuran Xhani. Përderisa mundësitë financiare janë i nderuar drejtor ku qenka një problem drejtohuni Ministrisë së Brendshme, drejtohuni ju të bashkisë për dicka që është punë emergjente nuk është punë dëshire apo vullneti. Unë nuk po kuptoj pse nuk është kompletuar që në fillim të vitit megjithatë ku kanë qenë pengesat që kjo nuk është kompletuar që në fillim të vitit sepse dhe vera po kalon megjithatë unë jam dakort për këto tre muajt edhe në vazhdim. Stafi zjarrfikës të jetë i plotë, i kompletuar dhe në gadishmëri për të ardhur në ndihmë qytetarëve. Bashkia të planifikojë buxhetin e detyrimin financiar sesa i detyrohemi zjarrfikësve dhe buxheti të jetë i përhershëm bashkë me stafin. Unë nuk e di ka të bëjë me jetë njerëzish.

Indrit Dedei. Prania e zjarrfikësve është e rëndësishme, po u dogjëm ne këtu cfarë i duhet Ministrisë së Brendshme që u dogjën ne këtu. Kështu që më e rëndësishme parandalimi sepse ndodh ngjarja pastaj e prit se ndodhi, më mirë shpëto këto që vijnë për qark me zinxhira sesa...

Rezart Vogli. Nuk është ai thelbi i projekt-vendimit...



Indrit Dedei. Themi atë që është e nevojshme.

Rezart Vogli. Thelbi i projekt-vendimit...

Indrit Dedei. Ka patur raste që janë djegur tre fëmijë, tre fëmijë brenda në shpi.

Rezart Vogli. Thelbi i projekt-vendimit është të shtohet stafi i zjarrfikësve me 3 punonjës jo se...

Hekuran Xhani. Më fal të shtohet apo të kompletohet?

Rezart Vogli. Të shtohet.

Hekuran Xhani. Të mos i ngatërrojme termat, pra ai nuk e ka të plotë organikën si përcakton ligji dhe thotë që për kaq banorë dhe këtij i nevojiten në bazë të organikës kaq zjarrfikës pra ne po miratojmë fondin për të paguar edhe punonjës për të kompletuar edhe organikën jo për shtim organike, pra të jemi të qartë.

Indrit Dedei. Jo për kompletim.

Hekuran Xhani. Prit pra se janë terma komplet të ndryshme.

Besnik Dushku. Shërbimi zjarrfikës është në varësi të dyfishtë jo vetëm i joni i bashkisë sonë por të gjitha shërbimet janë fikse në territorin e Shqipërisë kanë varësi të dyfishtë. Kemi nga drejtoria e përgjithshme e Ministrisë së Brendshme kemi dhe nga kryetari i bashkisë. Drejtoria thotë unë kam kompletuar me kaq, të tjerat ti kompletojë bashkia ka futur në nenin 9 tek ligji jonë të drejtat dhe përgjësitet e kryetarit të bashkisë. Dhe një detyra që ka kryetari i bashkisë kompletim me mjete dhe pajisje thot dhe kompletim të personelit zjarrfikës.

Hekuran Xhani. Pikërisht kjo është pyetja ime, pra këshilli mer vendim sot për plotësimin e organikës si detyrim që ka bashkia kundrejt drejtorisë së zjarrfikësve. Unë jam plotësisht dakort.

Mukades Gixhari. E hedhim në votim. Pro, Kundra, Abstenim, të gjithë Pro miratohet.

Mukades Gixhari. Faleminderit, zoti Besnik për informacionin që na dhe, faleminderit zoti Rezart.

-Miratohet me 16-vota pro, pika 8 (tetë) e rendit të ditës.



Vendim nr.22. Miratohet me 16 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3227/1.Prot datë 13.09.2023 “Për një ndryshim në vendimin Nr.77 datë 27.12.2023 ‘Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2023’ ”.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën 9 të rendit të ditës. Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin për servitut kalimi në pasurinë nr.1/187, zona kadastrale 3234, lagja nr.1, në Bashkinë Rrogozhinë” të kërkesës së z. Agron Aliu. Do të na referojë drejtori i urbanistikës zoti Geraldo Gjini. Përshëndetje, zoti Gerald.

Geraldo Gjini. Përshëndetje ! Në bashkinë Rrogozhinë ka ardhur një kërkesë nga zoti Agron Aliu i cili kërkon me vendim trajtimi. Ne si zyrë urbanistike bashkë me zyrën e kadastrës kërkuam informacion nga hipoteka për këtë pasuri që zoti Agron Aliu kishte dërguar. Nga informacioni që na erdhi nga hipoteka rruga e kuadrit kalon zoti Aliu është një pronë me pronarë të pa verifikuar kështu që ai nuk e ka pronë të vetën rrugën që kalon aktualisht, ky ka qenë qëllimi që ai ka kërkuar të hapim projektvendimin. Nga informacioni i kadastrës ne na erdhi që pasuria 11187 është një pronë shtet e cila e ka aktualisht e ka në përdorim vetë zoti Agron Aliu dhe duke qenë që rrugën ekzistuese ai e ka me numër pasurie 11186 dhe del me pronarë të paverifikuar ai kërkon që rruga të kompesohet me pasurinë që është pronë shtet dhe nesër pasnesër me një VKM mund ta marri. Kjo është e gjitha, ne morëm masa shkuam e verifikuan konflikte nuk është se kanë...

Mukades Gixhari. Mbarove?

Indrit Dedei. Mjafton mos kenë konflikte se në qoftë se kanë konflikte i fusim në sherr më keq.

Geraldo Gjini. Jo nuk kanë konflikte.

Indrit Dedei. Dhe na vjen keq.

Mukades Gixhari. Po, zoti Sokol.

Sokol Gosa. Gesi e ka përmbledhur problematikën e zotit Agron dhe unë e njoh mirë edhe vetë personin, mendoj të mos diskutojmë fare këtë pikë dhe të kalojmë direkt në votim.

Mukades Gixhari. Në rregull, e hedhim në votim Pro, Kundra, Abstenim? Të gjithë pro miratohet. Faleminderit.

-Miratohet me 16-vota pro, pika 9 (nëntë) e rendit të ditës.



Vendim nr.23. Miratohet me 16 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3257.Prot datë 14.09.2023 “Për miratimin për servitut kalimi në pasurinë nr.1/187, zona kadastrale 3234, lagja nr.1, Rrogozhinë të kërkesës së z. Agron Aliu ”.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës. Shqyrtim i analizës së Realizimit të të ardhurave për 6-mujorin e parë 2023, ardhur nga drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik. Fjala për drejtorin të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik zoti Orges Tosku.

Orges Tosku. Përshëndetje të gjithëve, të ardhurat për 6-mujorin e parë 2023 janë realizuar në shumën 56 milion 567 lekë për 6-mujorin e parë janë realizuar shuma rreth 72 milion lekë krahasuar më 6-mujorin e parë 2022 kundrejt 2023 kemi një mos realizim për rreth 50 milion lekë ose e përkthyer në përqindje 21%. Krahasuar me planin vjetor është realizuar për rreth 24% e tij, peshën kryesore e pamë tek komisioni që u mbledh dje me taksë tokë dhe zënia e hapësirës publike që është rreth 10milion lekë më pak e realizueshme dhe kjo ka ardhur për shkak se ka pasur disa ngatërresa në institucion dhe kjo taksë është shkarkuar në muajt në vijim sepse unë kam marrë edhe thesarin e Kavajës dhe ky mosrealizim është zeruar. Ne si drejtori i kemi bërë të gjitha përpjekjet që cdo debitorë të paraqitet pranë zyrës dhe të paguaj dicka.

Mukades Gixhari. Pyetje, po zoti Mitat Daja?

Mitat Daja. Domethënë i bie komplet një vit që përafërsisht për 6-mujorin e dytë sipas kësaj, nëse mblidhen po aq sa janë mbledhur edhe herën e parë i bie 100 milion taksa mund të mblidhen apo jo?

Orges Tosku. Jo,jo atëherë 100 milion lekë të vjetra flasim sepse është vetëm taksa...

Mitat Daja. Jo,jo këtu lart në 6-mujorin e parë të 2023 ke mbledhur 56 milion e ...

Orges Tosku. Po, 57 milion themi.

Mitat Daja. Po 57 milion, pra je 24 përqind të planit..

Orges Tosku. Po planit vjetorë.

Mitat Daja. Plani vjetor edhe 6 muaj ka mbetur deri tani.

Orges Tosku. Atëherë plani vjetorë nuk mund të jetë asnjëherë 100%.

Mitat Daja. I bie që 6 mujorin e dytë të bësh 75% .



Orges Tosku. Po nuk ka asnjëherë 100% realizim se i bie që të paguhet cdo lloj takse nga të gjithë.

Mitat Daja. 80%, 90% realizim. Deri sa shkon kjo?

Orges Tosku. Kjo arrin diku te 60%.

Mitat Daja. Sa?

Orges Tosku. 60% të planit.

Mitat Daja. Pra taksapaguesit e Rrogozhinës, 6 % dmth në 100 vetë 60 paguajnë dhe 40 nuk paguajnë? Dhe 3 janë më krenarët që jetojnë këtu në Rrogozhinë.

Orges Tosku. Mos themi që ka edhe këtu mes nesh.

Mitat Daja. Urdhëro?

Orges Tosku. Ka dhe mes nesh që mar dhe shkas...

Mitat Daja. E ke për mua?

Orges Tosku. Jo ka dhe tjerë.

Mitat Daja. Taksën ta paguajnë ato por në qoftë se e ke për mua.

Orges Tosku. Ne duhet të jemi shembull edhe do na ndjekin dhe duhet të jemi shembull për pagesën e taksës.

Mitat Daja. Për kë e ke, e ke për mua?

Orges Tosku. Për ty dhe për shumë tjerë.

Mitat Daja. Përmend emra.

Shpati Kolgega. Po flasim për buxheti e bashkisë nuk po flasim për...

Mitat Daja. Ti në drejtorinë tënde nuk ke ndjekur procedurën për të mbledhur të ardhurat e tua në rregull në qoftë se e ke për mua, në qoftë se e ke për dikë tjetër...



Mitat Daja. Unë nuk kam biznes, unë nuk kam biznes në emrin tim.

Shpati Kolgega. Zoti Mitat që të mos e bëjmë debat, a mbarove me shtjellimin?

Mitat Daja. Po mbaroi.

Shpati Kolgega. Në vijim të asaj që tha Mitati në qoftë se realizohet 60% çfarë do të thotë ky planifikim nuk është i saktë,

Orges Tosku. Atëherë dhe dhe...

Shpati Kolgega. Më fal apo të themi që kështu planifikohet gjithmonë dhe në fund fare, në qoftë se mbledhet 60% do të thotë që calon pak ky planifikimi se do të thotë që nuk mund të planifikosh 100%, ok mund të shkosh 90% 95% ose 92% është e pranueshme por të planifikosh 100% dhe të arrish 50% do të thotë që të paktën për vitin tjetër të bëjmë një lloj ndryshimi. Sepse atëherë shpenzimet janë në varësi të programimit pra në qoftë se ti planifikon 100 milion po e mar si shembull duhet të shpenzosh 100 milion. Nëse planifikon 100 milion dhe arrin të mbledhësh 50 ...

Orges Tosku. Si ta parashikojmë taksën e infrastrukturës ose taksën e hapësirës publike, i teket ministrisë nesër dhe nuk e jep.

Shpati Kolgega. Kjo ndodh më shumë për të kuptuar se çfarë ndodh me programimin.

Orges Tosku. Atëherë në marim të gjithë resurset që kemi, të gjithë ndërtesën, tokën bujqësore, hapësirat publike. Sepse marim shembullin për pjesën e plazhit atë e jep Ministria Turizmit i teket nesër dhe nuk e jep. Sot që flasin 70% publik dhe 30% privat nesër e bën 50 me 50, normalisht do të ketë ulje të ardhurash.

Shpati Kolgega. Më fal kam edhe një pyetje tjetër, kjo pjesa e planit sa përqind e të ardhurave zë në buxhet? Afërsisht?

Orges Tosku. 1/3 e realizojmë..

Shpati Kolgega. Domethënë 30 %.

Orges Tosku. Dicka më shumë edhe nga Spilleja, vija bregdetare që do ndërhyrë, hapësira publike.



Erind Tosku. Metodat që po përdorni mos janë jo të sakta për të mbledhur taksat e qytetarëve, hasni këto probleme nga qytetarë të ndryshëm..

Orges Tosku. Cfarë metode për shembull?

Erind Tosku. Atë se di unë por për mendimin tim duhen parë edhe metodat, ky 60% nuk është nga më të mirat që ka marë bashkia jonë.

Orges Tosku. Nga më të mirat.

Erind Tosku. Por mendoj të shikoni këto metoda që me të vërtetë po të hasim një veprimtari të bashkisë tonë ti vëmë në shfrytëzim të komunitetit.

Orges Tosku. Do ti ndjekim të gjitha metodat, do fillojmë me marrjen e masave.

Mukades Gixhari. Pyetje tjetër? Po zoti Indrit?

Indrit Dedei. Që të kuptoj dhe unë, që nga 2022 jemi vetëm brenda nuk shoh ndonjë përmirësim.

Orges Tosku. Ku bazohesh?

Indrit Dedei. Këtu pra.

Hekuran Xhani. 2022-2023 56 mijë,71 mijë

Orges Tosku. Këtë 6-mujorë është në rënie pra .

Indrit Dedei. Po pra në rënie.

Orges Tosku. Për shkak të kësaj që unë përmenda, po të shikoj se unë e marr...

Indrit Dedei. Më të përparshmet kanë qenë më mirë sesa ky se nuk më merr mendja që nga stacionet e plazhit të ketë mungesë në mbledhjen e taksave.

Orges Tosku. Shiko rakordimet e muajit gusht sesi janë.

Indrit Dedei. Ose varet se si ka qenë halli...



Shpati Kolgega. Lidhet pastaj me pjesën e abligimeve dhe rakordimet që kanë bërë me ministrinë.

Indrit Dedei. E rëndësishme është të mblidhen të ardhurat.

Mukades Gixhari. Ta dëgjojmë pak zotin Sokol Gosa.

Sokol Gosa. Kryetare.

Mukades Gixhari. Po Sokol.

Largohet nga mbledhja anëtarja e këshillit Alime Hoxha në kohën 1 orë;04 minuta të mbledhjes

Sokol Gosa. Nisur më shumë nga zona e plazhit rreth 30% apo jo, nuk e di Ges a mblidhen 100% këto?

Orges Tosku. Të ishin 100% këto ishim sipas planit.

Sokol Gosa. Të fillojmë me plazhin ë, të gjithë kanë paguar apo jo?

Orges Tosku. Po.

Sokol Gosa. Sa janë para që marim mund të më japësh një shifër?

Orges Tosku. Vetëm për rërën ne kemi arkëtin 302 milion lekë të vjetra.

Sokol Gosa. Ok vetëm nga rëra po tjerat?

Orges Tosku. Ke barin, hoteleritë bizneset e zonës.

Sokol Gosa. Po, por shuma sa mund të shkojë tek 700-800 milion?

Orges Tosku. Po

Sokol Gosa. Ok me plazhin jemi në rregull, keni bërë punë të mirë po tek këto tjerat pse nuk mblidhen?

Orges Tosku. Edhe tek ato mblidhen por aq është mundësia.



Sokol Gosa. Po sa nuk paguajnë, ka biznes që nuk paguan?

Orges Tosku. Ka edhe debitarë të vjetër ,unë aty kam gjetur edhe debitorë të 2011 e trashëgume.

Sokol Gosa. A e ke nxjerr një shifër?

Orges Tosku. Shifër konkrete tani nuk kam por...

Sokol Gosa. 20, 30, 40 lokale o Ges ka të ardhura dhe paguajnë. Flasim me rradhë ju lutem se unë ju dëgjova.

Mukades Gixhari. Po zoti Sokol.

Sokol Gosa. Kush nuk paguan?

Orges Tosku. Po të them që ka nga 2011 e deri sot që flasim..

Sokol Gosa. Po mirë ato e vazhdojnë programin e tyre?

Orges Tosku. Ne kemi marrë masat që na lejon ligji.

Sokol Gosa. Dhe e fundit, format cfarë ke përdorur?

Orges Tosku. Ne në bazë ligjit na lejohet ta cojmë për ndjekje penale.

Sokol Gosa. Erdhi fundi i vitit edhe 3 muaj të tjerë

Orges Tosku. Kemi bërë këto bllokimet e hipotekave, mjeteve në ndjekje penale mua nuk ma mban me shkuar

Sokol Gosa. Gesti ndërhyrja duhet bërë, duhet bërë maksimumi.

Mitat Daja. Gesti, bllokimet i keni bërë vetëm për armiq të apo edhe për miqtë?

Orges Tosku. Pa përjashtim.

Mitat Daja. Pa përjashtim ë,nuk e besoj po të hymë më thellë.



Mukades Gixhari. Zoti Hekuran po?

Hekuran Xhani. Dua të bëj një kërkesë, qytetarët duan të bëjnë legalizim me ligj dhe nuk po mundën ta bëjnë dot, ku ngec ky proces kaq gjithpërfshirës dhe me shumë interes nga qytetarët?

Orges Tosku. Në momentin që kadastra vazhdon procesin qytetari ka një detyrim në bashki të paguaj 3 % të cmimit të referencës. Por jo se bashkia bën legalizimin.

Hekuran Xhani. Unë e di që bashkia nuk bën legalizim por kryeministri i qytetarëve Rrogozhinë është zoti Edison Memolla, pra cdo qytetar kryemintër në Rrogozhinë ka Edison Memollën. Deri ku ka shkuar kjo punë sepse njerëzit kërkojnë legalizime dhe legalizime nuk bëhen, zëri duhet të shkojë deri atje ku është, rruga atje ku është dhe ku ngec.

Orges Tosku. Nuk kam tagrin të jap një përgjigje për këtë.

Hekuran Xhani. Po kush do ta përcjelli zërin e qytetarit meqenëse është një pengesë për qytetarin.

Shpati Kolgega. Duhet ta përcjelli ai që është në qeveri deputeti, përfaqësuesi qëndror por nuk besoj që është drejtori i taksave përgjegjës për legalizimet.

Hekuran Xhani. Jo unë i thashë që është një e ardhur shumë e mirë për bashkinë 3% e vlerës por plus është një kërkesë që njerëzit janë të detyruar edhe në dorë për të marrë dicka të ligjshme. Më e keqja është që njerëzit paguajnë taksë shpie kur shtëpinë nuk e kanë në hipotekë, pra shkojnë i marrin lekë qytetarit për shtëpinë kur ne nuk e njohim ligjërisht.

Orges Tosku. E parashikon dhe ligji.

Hekuran Xhani. Si e parashikon ligji?

Orges Tosku. Edhe në qoftë se nuk ke certifikatë pronësie je i detyruar të paguash taksën e ndërtesës.

Hekuran Xhani. Si mund të paguash taksën për dicka që nuk e ke pronën tënde.

Orges Tosku. Duke e verifikuar në terren sepse edhe ai që e ka bërë atë pse e ka bërë pa letra.

Hekuran Xhani. Kush e verifikon këtë gjë, ti e verifikon këtë gjë?



Orges Tosku. Po.

Hekuran Xhani. Mer tatimet dhe coja qytetarit ti.

Shpati Kolgega. Problemi i pronave është problem që e has gjithë Shqipëria.

Hekuran Xhani. Ne nuk do zgjidhim problemet e të gjithë Shqipërisë do zgjidhim problemet e Rrogozhinës prandaj jemi këtu.

Shpati Kolgega. Jemi pak jashtë teme por dakort jam për diskutimin, është çështje me shumë rëndësi me u diskutuar...

Orges Tosku. Sepse ato që veprojnë marin indicie.

Shpati Kolgega. Por një që nuk është legalizuar për shembull por është në proces legalizimi apo jo?

Hekuran Xhani. Atëherë si këshill bashkiak a kemi të drejtë edhe ne ti drejtohem zyrës së legalizimeve Aluizmit të Shqipërisë se pse ky proces nuk ecën përpara në emër të këshillit i drejtohem dhe presim një përgjigje. Pse njerëzit paguajnë dhe shtëpinë nuk e kanë me hipotekë.

Mukades Gixhari. Zoti Enver.

Enver Memolla. Në rradhë të parë përse i përket debatit nuk është rend dite, duhet ti përmbahemi rendit të ditës në rradhë të dytë...

Hekuran Xhani. Ore hipoteka është këtu, është rend dite nuk flas kokrra pas bregut unë. I shikon të ardhurat për legalizimit i ke këtu jo se nuk është rend dite. Rend dite nuk ishte zjarrfiksja dhe ne e futëm në rend dite, mos më përmend mua rendin e ditës.

Enver Memolla. Shqetësimi juaj është shumë i drejtë, ajo që the do ta bëj edhe unë atëherë meqënëse është pjesë shumë sensitive ndikon dhe tek taksat që mbledh bashkia të shikojmë të marrim një vendim që mbledhjen e rradhës të marrim një përfaqësues ASHK të jetë prezent për të dhënë këtë shpjegim, por mos bëj debat kur zotëria nuk ka kopetanca. Unë tani kam dy pyetje për drejtorin e taksave duke parë edhe uljen e të ardhurave. A ka ndikuar emigracioni në këtë pjesë?

Orges Tosku. Ajo është edhe një pikë kryesore sepse edhe ne cojmë njoftimet dhe shumica e



njoftimeve kthehen mbrapsh sepse nuk ka njerëz.

Ernver Memolla. Është një nga ndikuesit kryesorë.

Orges Tosku. Normalisht po.

Enver Memolla. Atëherë marr shkas edhe nga mbledhja e djeshme bashkë folëm ta kërkuam edhe në mbledhjen e komisionit planin 9 mujor të bashkisë Rrogozhinë, më fal ky 2 milionshi që ta shikojmë ne që është mbledh në 9 muaj, në mbledhjen e radhës. Ta dimë që në 9 mujor sa arrihet në përqindje mbledhja e taksave se në bazë të saj do bësh edhe paketën fiskale dhe do ta cosh për shqyrtim në anën tjetër.

Orges Tosku. Po.

Mukades Gixhari. Faleminderit.

Enver Memolla. Dhe përsa i përket propozimit të bërë nga zoti Hekuran por edhe unë për pjesën e kadastrës le të vijë.

Silvana Aliu. Si mund ti marrësh një pagesë një shtëpie që nuk ka legalizim.

Orges Tosku. E parashikon ligji, ne këtu bazohemi diku...

Shpati Kolgega. Më fal një pyetje, ti ke ndërtuar një shpi me leje dhe paguan taksën, ai e ka ndërtuar pa leje pa asgjë dhe të mos paguaj as taksën,si? Ta marim me logjikë pra ti paguan edhe taksat e ke dhe lejen e ke dhe të rregullt, ai e ka pa leje dhe nuk paguan as taksat po e marrim nga ana logjike.

Hekuran Xhani. Nuk është faji i tij që e ka ndërtuar pa leje.

Orges Tosku. Po pse e ke ndërtuar pa leje, ai thotë bën letrat dhe më pas bën ndërtimin.

Indrit Dedei. Ti pse e ke bërë pa leje, pse ke ndërtuar?

Orges Tosku. Ligji thot mos ndërto pa letra dhe ne prap kemi ndërtuar.

Mukades Gixhari. Vazhdojmë në pikën tjetër, faleminderit. Vazhdojmë në pikën 11. Shqyrtim i Informacionit mbi punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve online, projekteve të reja,



procesin e legalizimeve dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave ardhur nga Drejtoria e Politikave Urbane pranë Bashkisë Rrogozhinë. Fjala për drejtorin e urbanistikës zoti Geraldo Gjini.

Geraldo Gjini. Përshëndetje edhe njëherë, drejtoria e politikave urbane ka në strukturën e saj tre sektorë, që janë sektori i lejeve shpëtimore, sektori i projektimit të menaxhimit si dhe sektori i kadastrës. Përgjatë muajve Janar-Qershor 2023 në sistemin tonë janë shkurtuar gjithsej 94 praktika, nga këto janë leje ndërtimi, leje rindërtimi, deklarata të kryera punimesh etj. Përsa i takon ecurisë së legalizimit për periudhën Janar-Qershor 2023 janë mbledhur taksat me vlerë 2 milion e 7 qind e 11 mijë e 5qind e 94 lekë. Nga drejtoria vendore e agjensisë shtetërore të kadastrës janë ndryshuar 115 pika të drejta të qytetarëve të cilë janë ngarkuar me detyrimin e pagesës. Këto janë edhe ato që po flisnit edhe pak më parë, shumë nga këto jetojnë jashtë të ardhurat nuk paraqiten, kur vijnë nuk vijnë në bashki të bëjnë pagesën e taksave. Për kërkesën për projektet e reja, drejtoria jonë merret me realizimin e projektvendimeve për mirëmbajtje të zakonshme si janë kanalet, riparime ura buqësorë etj. Drejtoria Politike Urbane gjithashtu merret edhe me punë të tjera si janë lëshimi i vërtetimit për banimin, lëshimi i miratimit për kërkesat e përpunimeve që nuk kërkojnë leje miratimi që janë suvatimet, pllakat, hidrosanitaret, elektriket etj. Gjithashtu në drejtorinë tonë jemi marrë me sqarimin e të gjithë qytetarëve që kanë patur dëmtime nga tërmeti, që janë në proces për të marrë lejen e ndërtimit, janë bërë vërtetime për tokat buqësore dhe informacione të ndryshme kushtet e zhvillimit apo pjesa e bregdetit ose bashkia kush është i interesuar që vjen e interesohet a lejohet ndërtimi etj. Në sektorin e kadastrës janë evidentuar probleme nga veprimtaria e përgjithshme si dhe shqetësime të ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, ku janë gjetur zgjidhjet përkatëse në pjesën më të madhe të rasteve ka dhe raste pastaj që... Zyra e kadastrës për periudhën Janar-Qershor 2023 sipas ligjit nr 42/2020 të vendimit të këshillit të ministrave ka ndjekur procedurën për përditësimin e listës të pronave në bashkinë Rrogozhinë për kalimin në pronësi të sipërfaqes 9650 metër katrorë në fshatin Ballaj njësia Gosë. Gjithashtu janë trajtuar 20 kërkesa mbi pronën dhe janë bërë verifikime në terren ku janë mbajtur procesverbali përkatës ose kanë marrëpërgjigje me shkrim kur një kërkesë është përsëritur. Zyra e kadastrës ka shkëmbyer informacion me agjensinë shtetërore të kadastrës për saktësinë dhe regjistrimin e pronës për të përgatitur dhe për të sjellë dokumentacionet ligjore për regjistrimin e pronave. Nga viti 2021-2023 janë depozituar pranë agjensisë shtetërore të kadastrës dokumentacione mbi zbatimin e ligjit 20/2020 në zbatim të legjisllacionit në fuqi për kadastrën është bërë azhurnimi i dokumentacionit kadestrial mbështetur në ligjin 102/57. 2010 duke ju përcjellë drejtorisë administrimin e mbrojtjes së tokës pranë këshillit të qarkut. Zyra e kadastrës dhe e pronave ka përgatitur dhe ka përcjellë dokumentacionin teknik ligjor për regjistrimin e asetit publik në fushën e arsimit, sporti në bashkinë Rrogozhinë duke qenë se në bashkinë Rrogozhinë janë nërë disa rindërtime shkollave etj. Këto kanë qenë pa dokument pronësie, ka qenë tokë shtet por nuk kanë patur certifikatën e pronësisë. Zyra e kadastrës ka përgatitur dokumentacion në mbështetje



të ligjit 86 / 2018 i lëshuar mbi interesat pasuror të shtetit mbi pronat publike në pronësi apo në përdorim të bashkisë Rrogozhinë. Zyra e kadastrës dhe pronave ka asistuar cdo qytetar për cdo problematikë duke vënë në dispozicion dokumentacionet e nevojshme që janë kërkuar nga ata. Kjo është pak a shumë pasqyra për periudhën Janar- Qershor 2023.

Mukades Gixhari. Ndonjë pyetje? Po zoti Mitat?

Mitat Daja. A ka bashkia Rrogozhinë, inventarë pronash që mund të jenë publike?

Geraldo Gjini. Po ka.

Mitat Daja. Domethënë cfarë tokash janë, tokë buqësore, kullotë, pyll cfarë mund të jenë? Shesh ndërtimi?

Geraldo Gjini. Janë në inventarë të gjitha.

Mitat Daja. Domethënë është sheshi i ndërtimit, dua të bëj një pallat nesër.

Geraldo Gjini. Tani ti pyete a ka inventarë ka tani unë se di se cfarë...

Mitat Daja. Nuk e dinë, kush do na e japi përgjigjen sot ne, kush na jep informacion për këtë punë?

Geraldo Gjini. Të japim një kopje financiare po deshe...

Mitat Daja. Atë e di ti.

Mukades Gixhari. Po zoti Hekuran.

Hekuran Xhani. Po të njëjtën pyetje desha të bëj edhe unë si Mitati.

Mitat Daja. Ka dhe njerëz që janë të interesuar duan të bëjnë investime ndaj duhet të keni një...

Geraldo Gjini. Cfarë thatë më fal?

Mitat Daja. Mund të ketë njerëz që duan të bëjnë investime për të bërë kullota apo dicka tjetër.

Geraldo Gjini. Nuk meret drejtorja e urbanistikës me dhënien e ...

Mitat Daja. Jo po flas inventari, kaq kisha inventari.



Hekuran Xhani. Pronat publike se kjo është tani se me pronat private mbaruam, a janë të gjitha të regjistruara në librin inventar, flas për këtë njësi administrative?

Geraldo Gjini. Ato janë të regjistruara në asetet shtetërore të bashkisë por nuk janë të gjitha me certifikatë, ne me këtë jemi duke u marrë normalisht jemi duke ndjekur procedurën sepse duan kohën e vetë, e kemi vazhduar si procedurë kemi gati 6 muaj.

Mukades Gixhari. Pyetje tjetër ? Po zoti Indrit?

Indrit Dedei. Duhet të bëhemi pak më të thjeshtë me këtë pjesë, 2 mijë euro i merr shefi policisë, 2 mijë euro i merr sekseri bashkisë 3 mijë euro i merr Bashkimi, sa?

Geraldo Gjini. Pjesa me e madhe e shpijave janë ato që diskutuam më lart nuk kanë numër popullsie.

Indrit Dedei. Shefi i fundit i policisë nuk merrte asnjë polic nga mbrapa dhe 5min e fundit i shfrytëzonte deri në orën 2 rregulloren ktëtu...

Hekuran Xhani. Nuk ishte difekti i bashkisë por ishte difekti nga lart.

Indrit Dedei. Jo jo kjo është një gjë.

Hekuran Xhani. Nuk ishte defekti i bashkisë.

Geraldo Gjini. Nuk është tagri i drejtorisë politike urbane kontrolli në terren për ndërtimet pa leje. Praktika për lejen e ndërtimit është shumë e thjeshtë por pjesa më e madhe e bashkëqytetarëve tonë si në bashkinë e Rrogozhinës si dhe në njësinë administrative nuk disponojnë dokumentin e pronësisë për tokën dhe kjo është dhe kjo është mungesa që nuk mund të aplikojnë dot për leje ndërtimi. Në qoftë se e ke për leje ndërtimi ne jemi ndër bashkitë që kemi taksat më të vogla dhe shpenzimet shkojnë shumë më pak.

Mukades Gixhari. Faleminderit Geraldo.

Geraldo Gjini. Faleminderit.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën 12. Informacion nga Drejtori e Bujqësisë, mbi punën e bërë dhe masat që do të merren në sistemin e kullimit për periudhën Shtator 2023-Mars 2024. Drejtorit të bujqësisë para mbledhjes i doli një punë personale emergjente dhe nuk ndodhet. Jeni dakort që të relatojë zoti Artur Kaja?



Mitat Daja. Jo më le të vijë drejtori herën tjetër se kto drejtorat e bashkisë... në qoftë se do ta bëjmë gallatë.

Shpati Kolgega. Në qoftë se është në emër të drejtorisë së buqsisë ai mund të vazhdojë.

Mitat Daja. Arturi do të flasi për pyjet.

Mukades Gixhari. Jeni dakort të vazhdojmë.

Mitat Daja. Më fal pak zonja kryetare kan nevojë të them dicka, ne me datë 5 bëmë një takim këtu për arsimin, ai drejtori i arsimit të bashkisë që solli përgjegjësia herën tjetër në fakt ishte në konflikt interesi me mua dhe nuk denjoi të vijë, se ai është ai që mat performancën e mësuesve nuk denjoi të vijë këtë rradhë se duhet të vinte dhe ai. Drejtorat e bashkisë duhet të vijnë të gjithë se pika e fundit në rend dite është të ndryshme, unë kam një pyetje për drejtorin e arsimit ku është drejtori i arsimit që nuk vjen këtu, ku është ai drejtori tjetër që nuk vjen këtu. Dakort e justifikuar Andin, se nuk bën të tilla veprime por në përgjersi drejtorat e bashkisë ju siguroj të gjithëve ndoshta nuk doni ta dini ju të krahit tjetër he se këshill janë, kush po e vret mendjen për ato. Ky është gjykimi i atyre..

Shpati Kolgega. Mos fol në emrin tonë.

Mitat Daja. Jo unë nuk po flas në emrin tënd, tuajin por në emrin tim në emër të atyre se ato flasin kështu, nuk kam punë me ju unë fare. Është shumë e vërtetë nuk e kanë në konsideratë fare, dhe në qoftë se ato nuk vijnë këtu nuk ia vlen fare të merremi me ato.

Shpati Kolgega. Tani unë shikoj që kemi një shumicë drejtorash nuk është kjo që thua ti i financës po, i taksës po, i shërbimeve po tani..

Mitat Daja. Në qoftë se i duket vetja më të mencur le ta gjenë në vend tjetër dhe jo këtu tek ne apo tek unë më saktë.

Hekuran Xhani. Unë jam plotësisht dakort.

Mitat Daja. Ku është drejtori i arsimit këtu?

Hekuran Xhani. Mështetjet e antitezave dhe mendimeve tuaja, bujqësia mbulon 90% për të mos dhënë më shumë të të ardhurave të familjarëve, fermerë të kësaj bashkie dhe unë mendoj meqë është një mundësi që mbulon të ardhura për qytetarët se kjo është bashki që kemi dhe det por që më shumë merremi me bujqësi unë mendoj që ta shtyjme dhe këtu të jetë drejtori i zyrës së



bujqësisë sepse vjeshta po vjen kemi goxha probleme dhe të mos e kalojmë sikur, sic ngrejtëm atë vendimin që ta ndihmojmë për së gjalli dhe shkuam pas vdekjes. Bujqësia është ai tha për kanalet, një shi me ra zjarri na iku por na vjen përmbytja prandaj drejtori i zyrës së bujqësisë duhet të jetë edhe për mua në mbështetje të Mitatit të gjithë drejtorat duhen të jenë këtu për të raportuar.

Mukades Gixhari. Zoti Enver.

Enver Memolla. Duke parë që sic e tha dhe zoti Hekuran përsa i përket drejtorisë së bujqësisë duhet dicka jashtë rradhe, mar shkas nga problematikat që kemi është sektori më i ndjshëm në bashki, për të shmangur edhe debatet jo erdhi nuk erdhi në emër të grupit unë mendoj që ta shtymë në mbledhjen e rradhës e vazhdojmë tek pika e parë e rendit të ditës nuk e di nëse kolegët janë dakort të vazhdojmë me këtë pjesë.

Mukades Gixhari. Jeni dakort te nderuar kolegë ta shtymë në rend të ditës?

Lulzim Hasa. Dakort.

Sokol Gosa. Dakort.

Mitat Daja. Dakort.

Saimir Cani. Dakort.

Mukades Gixhari. Kalojmë në pikën 13. Informacion mbi punën e bërë nga sektori i pyjeve dhe përmirësimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë. Përshëndetje zoti Artur.

Artur Kaja. Përshëndetje zonja kryetare përshëndetje të nderuar anëtarë në rradhë të parë ju uroj suksese në punën tuaj. Unë jam Artur Kaja shefi i sektorit të pyjeve në bashki, përsa i përket sektorit të pyjeve në bashki, organizon punën në bazë të ligjit të pyjeve. Qëllimi kryesorë i punës tonë është mbrojtja e pyjeve, pasuri me rëndësi të vecantë për vlerat që kanë. Zyra e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar vendore, miratuese, orientuese, mbrojtëse, kontrolluese e veprimtarive të paligjshme pyjor bashkiak. Sektori i pyjeve në bashkinë Rrogozhinë ka një organikë të tij një specialist me arsim të lartë që është shefi i sektorit si dhe 3 roje pyjesh në zonën pyjore. Ky sektor e organizon punën e tij në bazë të planeve vjetore dhe mujore të hartuara. Nga ana e sektorit të pyjeve sipas planit të hartuar në zonën përreth ku ka prerje të pyjeve të paligjshme, mbrojtja e shtëpive nga zjarri dhe për cdo rast në akt kontrolli në bazë të shkeljeve që kontaton. Në raste ka patur konflikte shërbimi mujore të njësisë tonë por puna e shërbimit ka qenë e mirë. Në lidhje me mbrojtjen e pyjeve nga zjarri ka patur bashkëpunim me



shërbime të zjarrfikësen e vendit, nuk ka patur zjarre në pyje. Ne këtë qëllim kemi cdo vit të hartojmë plane personale ku të ketë ndërhyrje të skuadër zjarrfikëse në cdo fshat të njësisë të qeverisë vendore. Ne kemi marrë gati 19 kontrata të cilët me kalimin e viteve janë mbyllur për pasojat të ndryshme që i kam sqaruar më poshtë. Aktualisht sot vazhdojnë 5 kontrata ndërsa të tjerat presin të interesohen. Përveç këtyre sektori i pyjeve ka nevojë për fonde për shuarjen e zjarreve dhe investime për projektet e miratuara që cdo vit i miratojmë dhe presim që të investohen. Këtë kisha për pyjet.

Mukades Gixhari. Po zoti Hekuran.

Hekuran Xhani. Sa hektarë jetë ka në inventarë drejtoria juaj për bashkinë Rrogozhinë, afërsisht?

Artur Kaja. Sektori i pyjeve ka VKM 144 ka sqaruar 1725 hektarë që ka në pyje dhe 849 në kullotë.

Hekuran Xhani. Kush futet tek kullotat?

Mitat Daja? Sa ishin kullota Artur?

Artur Kaja. Të saktë nuk e kam por 849 kullota sepse këto kullata janë transferuar që nga vendimi 700 të vitit...

Mitat Daja. Dakort, dakort se ju kur planifikoni planifikoni për 1700 e ca pyje por mund të ketë edhe 3000 por ti 1700 planifikon?

Artur Kaja. Unë 1700 hektarë pyjesh kam në pronësi ose inventarë më mirë dhe nga këto 1800 janë pyje të tjerat kullota.

Mitat Daja. 849 hektarë janë kullota.

Artur Kaja. Po

Mitat Daja. Pra janë të lira apo i ke me kontata me gjëra?

Artur Kaja. Më fal, këto nuk janë të lira fare se ky është një inventarë që ne na është thënë nga ish drejtoria në Kavajë, këto janë me vendimin 700 të vitit 95 po flasim për vitin 95 e deri në 2023 shumë sipërfaqe me kullota janë ndërtuar edhe lagje edhe lagje të tëra me banesa.



Mitat Daja. Po mirë kur është krijuar sektori i pyjeve në bashkinë e Rrogozhinës?

Artur Kaja. 2016 jo vetëm në Rrogozhinë po në të gjithë Shqipërinë.

Mitat Daja. Nga 2016 deri tani ju nuk keni bërë ndonjë inventarë aktual që ta dini ku jeni?

Artur Kaja. Inventari ka kosto.

Mitat Daja. Kosto ke drejtorin aty të financave dhe atij kërkoi ske punë me ne.

Artur Kaja. Nuk flitet për 1 milion, 2 milion lekë të vjetra ose të reja është shumë që tani është një projekt i pyjeve që ka një vit që ka filluar, po bën regjistrimin e të gjithë kullotave që ndodhen në të gjithë Shqipërinë por edhe në bashkinë Rrogozhinë. Pasi të bëhet ky projekt të mbaroi për regjistrimin e tyre ne do marim një të dhënë të saktë se sa.

Mitat Daja. Dakort po kur do të bëhet ato të pyjeve.

Artur Kaja. Ajo ka një vit që është duke u proceduar.

Hekuran Xhani. Drejtor, kodrat e bregut me shkurre pjesë e drejtorisë së juaj janë apo jo?

Artur Kaja. Atëherë duhet të keni yë qartë 2 fakte, një fakt..

Hekuran Xhani. Kodrat e bregut që kanë qenë pjesë e pyjores më përpara ju kanë kaluar juve në inventarë pavarësisht se.

Artur Kaja. Ne në 2016 kemi marrë secili inventarin sipas bashkive me ndarje territoriale, projekti që kam patur unë para në qoftë se unë kam marrë arën 2 mijë e 800 hektarë gjithsej pyje, kullotë që diskutuam përvec tyre ka një sipërfaqe mbi 2mijë hektarë pyje që i ka patur komuna, kur isha në pyjore pata filluar një farë regjistrimi për të bërë një tabelë dhe do ta bëj shumë shpejt por për momentin unë jam vetëm 1 specialist dhe cfarë të bëj mbrojtjen, menaxhimin apo këto të tjerat. Edhe kjo do të bëhet se ka shumë pyje edhe Gosa që shikoni ju kodrat e Gosës ku kalojnë pyje, Gosa nuk ka asnjë hektarë pyje te ne se cfarë mund të ketë te kadastra bujqësore e njësisë ka pyje. Edhe Sinaballaj mund të ketë 1000 hektarë pyje të ndara pjesë pjesë por në kadastrë bujqësore ska, ato duhen futur dhe do kalojmë te vendimi.

Hekuran Xhani. Nuk na prishin punë pyjet e Gosës apo Lekaj na prishin punë kodrat e bregut në fund të fundit investime po bëhen mirë bëjnë që i bëjnë, por ti bëjnë të ligjshme dhe ato që bëhen të ligjshme ti paguajnë bashkisë dhe të ardhurat që i vijnë bashkisë i bëhen shërbim



qytetarit. Kodrat e bregut kanë qenë pjesë e pyjores historikisht, është ajo pjesë që është futur në pjesën e investimeve unë nuk e di si me leje apo pa leje. Megjithatë është mirë që ti ta kesh evidencën, këto kodra janë të drejtorisë tënde, kjo pjesë shkurresh...?

Artur Kaja. Meqënëse po flet për pjesën poshtë nga pas Patk-Milot këto kodra përfshijnë vreshta, pemëtore dhe pyjet dhe ne 85 nuk janë futur në inventarin e pyjeve sepse atëherë regjimi ka patur si qëllim mbjelljen e ullijve, rrushit etj Meqëse do bëhet kjo punë ato janë pyje por janë të ndara dhe përcaktuara si mos më keq.

Hekuran Xhani. Shkurt dhe qartë a i ke në inventarë apo jo kaq?

Artur Kaja.Në inventar të drejtorisë nuk i kam, në inventarin e komunës ka parcela.

Hekuran Xhani. Ajo ka qenë pjesë pyjore historikisht, prandaj po them po qe bërë me ndryshime të vendimit të qarkut.

Artur Kaja. Edhe kadatra edhe Kryevidhi parcelën x e ka pyll po unë nuk e kam pas këtë se ka qenë në dispozicion të komunës atëherë.

Hekuran Xhani. Drejtor të falenderoj shumë për sinqeritetin dhe shpjegimet.

Mitat Daja. Drejtor, pse nuk një ide ndoshta vlen që herë pas here të bëhen projekte të vogla të presim dicka nga këtë në bashkëpunim me shkollat, komuniteti me njerëzit keni projektuar ndonjë gjë të tillë? Sepse mund të bëhen edhe me donatorë privat mund ti blenë nxënësit e shkollës, mësuesit nuk është e dhënë.

Artur Kaja. Dhjetori është nga ana jonë si inxhinier pyjesh muaj i pyjeve, Dhjetor-Mars, ne cdo muaj, cdo vit vjet për shembull morëm në mënyrë simbolike 250 fidanë deri tek pishat bishti i zhurit, kemi mbledhë nëpër shkolla, Vilë por ne nuk kemi një fond të caktuar ta vëmë në dispozicion. Pyjet kanë shumë nevojë edhe për mbjellje, zëvendësime mbrojtje nga zjarri kanë nevojë edhe për ujtarë pyjesh por mundësitat e bashkisë ne si bashki kaq e kemi..

Mitat Daja. Ngelët duke i qarë hallin bashkisë.

Artur Kaja. Unë nuk po i qaj hallin

Hekuran Xhani. Ai i qan hallin vetes Mitat nuk e sheh që thot jam drejtor në zyrën e projekteve merr punonjës.



Mitat Daja. Pse nuk ia kërkon bashkisë, kërkoja bashkisë se ti akoma nuk ke karburant për të lëviz për ti parë pyjet vetë.

Artur Kaja. Unë po vij dhe nuk po i diskutoj këto, sot isha Spille, dje isha Spille do shkoj prap..

Indrit Dedei. Me makinën tate ke shkuar, ke shkuar ndonjëherë atje lart ti

Artur Kaja. Kam shkuar tek të gjitha.

Indrit Dedei. Më trego njëherë ku ke shkuar?

Artur Kaja. Damarkaj e di ti ku është Damarkaj

Indrit Dedei. Po e di ke shkuar ke hëng ndonjë mish keci

Artur Kaja. Tani kur bën punën edhe do të hash.

Mukades Gixhari. Japim pak me seriozitet bisedës ju lutem.

Erind Tosku. Indrit të bëj dhe unë disa pyetje?

Artur Kaja. Në Damarkaj kemi kryer kemi kryer punime ku komuniteti atje është...

Indrit Dedei. Unë nga atje jam vetë, nga je ti se unë kaq stë kam parë ndonjëherë? Më ke parë ndonjëherë ti mua?

Artur Kaja. Atëherë pse nuk jemi parë bashkë ti do të bësh kështu, mund të pyesësh banorët e zonës atje, Hysen Damarkaj Ben Damarkaj i njeh e pra?

Indrit Dedei. Është një firmë që ka marrë një tender para 2muajsh 3 muajsh për mbjellje pemësh a mirëmbajtje pemësh një firmë nuk e di nga është nga Berati ë?

Artur Kaja. Se di, se firma mund të vijë por në gjithë Shqipërinë nuk njoh tenderat..

Indrit Dedei. Për mirëmbajtjen e bashkisë duhet ta dish ti jan diku tek 4 mijë.

Artur Kaja. Bashkinë tonë?

Indrit Dedei. Po bashkinë tonë, për mirëmbajtje dhe mbjellje pemësh.



Artur Kaja. Jo në bashkinë tonë nuk është fare ky tender.

Indrit Dedei. Nuk ka mundësi, jam i sigurtë për këtë që ka kaluar një tender në një firmë Berati.

Artur Kaja. Nuk kam dijeni.

Mukades Gixhari. Nuk ka informacion.

Artur Kaja. Nuk kam pse, mund të vij por ne nuk kemi ndonjë fond për mbjellje pemësh.

Indrit Dedei. Kuptoj por do ta gjej.

Erind Tosku. Keni thënë që në sektorin tuaj të pyjeve kanë qenë 19 kontrata të ngrijtura dhe kenirënë në 7, a mund të më thoni pse keni rënë në 7 afarë arsyesh ka pasur personat që lidhin kontratën, nga 7 ta bëjmë 10 dhe pse nuk i bëjmë 10. Pyetja e dytë nga bashkia deri tek pjesa burgut janë ato pishat që bëjnë problem mbajnë pislliqe, është bërë problem edhe nga banorët që jetojnë atje dhe kalimtarët. A ka ndonjë projekt nga drejtoria e pyjeve se si mund ta zgjidhim këtë lloj çështje dhe se si mund të merren masa sepse fëmijëve i bën alergji po behet problematikë në sistemin rrugor edhe për mbajtjen e papastërtive, unë këto 2 pyetje kisha.

Artur Kaja. Pyetja e parë atëherë këto kontrata 19 biles kanë qenë 21 që janë lidhur 2013. Ne si drejtori duke mos patur informacion atëherë them se kadatra apo këshilli i qarkut jepnin prona dhe ne nuk kishim informacion. Atëherë ne i dhamë në 2013 pa i dhënë me qera sipas ligjit etj etj, në 2015 ndodhi ky skandali i tokave që jeni të gjithë në dijeni që një person apo të gjithë personat që kanë marrë sipërfaqe 1 hektare ose 2 ose 5000-7000 metra pjesa para dilte i x me kontratë pronësie edhe ai ma le tokën se unë nuk kam ardhur me bllokuar tjetrin kështu nuk paguan më dhe ja prishëm kontratat këtë shpjegime ia kemi dhënë të gjithëve edhe TVSH, domethënë këto persona kanë patur konflikte se në 2015 kjo figuron tokë bujqësore.

Erind Tosku. Po kuptoj.

Artur Kaja. Tani për pikën e dytë kemi nevojë sepse pyjet ofrojnë potencial për vend me qera do vi dhe rasti që ne do ofrojmë projekt vendime për ti dhënë me qera sipas kërkesave që kërkojnë sepse pyjet jepen për shumë qëllime për turizëm, agroturizëm për fidanishte etj etj ka shumë funksione të tyre. Kështu që dhënia me qera ndikon në shtimin e tyre.

Erind Tosku. Po pishat nga bashkia te burgu?



Artur Kaja. Përsa i përket kësaj këto merren në Serbi kemi patur dhe një ankesë dhe duhet një vendim këshilli që të priten këto pemë se kanë një kosto prerje pastaj duhet të zëvendësohen që ka kosto. Në qoftë se këshilli bashkiak ose bashkia e shohin të arsyeshme prerjen e tyre.

Erind Tosku. A keni bërë një projekt të tillë sa mund të shkoj të bëjmë prerje të tyre nëse vendosim apo jo?

Artur Kaja. Unë mund të bëj projekte që do mbillen ato pyjet.

Sokol Gosa. Një pyetje kisha për drejtorin, këto tokat, kodrat në Okshtum se për bregdetin dihen kujt janë dhënë, kush i ka ku kanë qenë kullotat më para Okshtum, Lekaj ka informacion?

Artur Kaja. Besoj do të dalësh aty ku kam dhënë me qera, atëherë nuk janë pyje por mund të jap një shpjegim se e di çështjen. Ato janë toka bujqësore më zërin kadastral pemë, arë, vreshtë, etj etj që bashkia ka të drejtë ti japi me qera sipas udhëzimit 2 të vitit 2013 dhe për të është ndjekur procedura ligjore, është dhënë me këshill bashkiak. Si puna asaj ne shikojmë që jepen komplet tokat që janë mbi 1000 hektarë, kemi nga 1000 hektarë nga Kryeluzaj në Sinaballaj që i kanë zënë fshatarët me ullinj, kanë nga 20 vjet që ne nuk mund të ja presim. Ajo duhet të ishte prap një pikë e këshillit që të bëheshin me kontrata dhe viheshin propozimet nga ana jonë sepse ai ka 20 vjet që e shfrytëzon atë dhe nuk ka paguar në bashki. Duke bërë kontratën ai identifikohet dhe i mbahen të ardhura se spo kemi lekë për rroga. Ka shumë sipërfaqe, kjo ka qenë edhe kritikë e KLSH herën e fundit pse nuk e keni dhënë deri tani por shumë herë kemi patur përplasje pse ta japim, kur e japin pse, ta marr unë, ka 30 vite që rrinë ato shkurre aty ka dhe sipërfaqe të tjera prap. Kush nga ne e kërkoi dhe nuk e mori, kur e mer dikush themi pse se mora unë. Zotëri ka për të gjithë aty hajde zbato ligjin merre sipas asaj, investo ato që të lejon ligji.

Hekuran Xhani. Sa i detyrohen bashkisë?

Artur Kaja. Zotëria paguan 5 milion e 600 mij lekë cdo vit.

Hekuran Xhani. Në rregull dhe tokën e mirëmban edhe investim mer.

Artur Kaja. Normal nga ferra të bëhet...

Hekuran Xhani. Jam plotësisht dakort me ty për ullishten dac me kontratë ato ullijnë duhen regjistruar, ai që i ka mbjellur se ulliri është monopol shteti dhe është bimë shumë vjecare dhe ullijtë futen te kultura shumë vjecare dhe është mirë që ti bëjmë një procesvendim ne si këshill sepse kërkojnë dhe fermerët që ta dimë që ka 20 sikur 150 lekë për ulli me i marr asaj zone.



Mitat Daja. Pyetja ime është kjo, ju ofroni shërbimin e prerjes së druve, a ka ndodhur ndonjë herë kjo?

Artur Kaja. Pak më parë unë përmenda se bashkia Rrogozhinë pjesën më të madhe e ka me pyje halorë apo pisha që nuk ka nevojë për...

Mitat Daja. Dua të di a ofrohet si shërbim?

Artur Kaja. Po ka se zonat e thella që janë atje sipër kanë ardhur kanë marrë pre 2 mij lekë dru zjarri pishë dhe e kanë përdorur. Ligji ka këtë që kryeplaku merr kërkesat e gjithë banorëve sa metra do gjithsecili.

Mitat Daja. Ajo është çështje tjetër, ka ndodh ska ndodh?

Artur Kaja. Ka pas raste janë dhënë.

Mitat Daja. Dakort, sugjerimi tjetër është për pishat në Spille, kujdesuni për ato pisha atje, nuk e di si është forma që të kujdeseni se jeni teknik të asaj pune, krijoni projekt se si të arrini të kujdeseni për pishat atje se është gjëja më e bukur që kemi në këtë vend.

Artur Kaja. Në çfarë aspekti e kishe?

Mitat Daja. Shoh që po degradojnë po thahen.

Artur Kaja. Atëherë në qoftë se ke parë pjesën nga bregu i detit, rëra bën punën e vet. Ne normalisht duhet të bëjmë një krasitje të heqim atë imazhin e keq ose mund ti japim edhe leje objekteve aty që të veprojnë.

Mitat Daja. Është gjëja më e bukur që kemi, sugjerim është ky.

Mukades Gixhari. Pyetje tjetër? Zoti Rezart?

Rezart Vogli. Lidhur me një shqetsim që e shprehu zoti Indrit pak më parë për mbjelljen e shkurreve, të sqaroj dhe këshilltarët besoj se i referohet një rrjeti social që bashkia Rrogozhinë bën vjedhje për një tender. Është krejt e kundërta, bëhet fjalë për kontratën e pastrimit dhe shërbimit të bashkisë Rrogozhinë. Në faqen zyrtare të ATP ku hidhen punime publike janë listuar të gjitha veprimtaritë e punës së bashkisë Rrogozhinë ndërsa rrjeti social është tjetër gjë.



Mukades Gixhari. Pika tjetër. Shqyrtim i kërkesës së ardhur nga Këshilli Mbikqyrës i Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a për dhënie opinionimi mbi propozimin për aplikimin e tarifave të reja në Bashkinë Rrogozhinë. Përfaqesuesi i Ujësjellësit Kanalizimeve Durrës sh.a.

Erida Hoxha. Përshëndetje unë jam Erida Hoxha, me pozicion nga reforma e marrë vjet në Mars për kanalizimet, i formës VKM 102 për kanalizimet Rrogozhina ishte në reformë për tu bërë pjesë e Durrësit, për tu bërë pjesë si Kruja, Kavaja Durrësi vetë. Nisma për të ndryshuar tarifat ishte pikë së pari duke marrë parasysh situatën financiare të rënduar që ne kemi marrë në dorëzim nga Rrogozhina. Është vënë në dispozicion në dijenë time që ka një akumulim borxhesh prej një 10 vjecari të mirë besoj se jeni vënë në dijeni që deklarancat kanë një kapitalizim prej 3 vitesh kjo shoqërohet edhe me situata të rënuara ku ka punonjës që kanë pakënaqësi në përparime, përparim nga OSHE, vetë OSHE që i bie shumë lart 159 milion lekë borxh detyrim, ka detyrime dhe furnitura 2.5 milion lekë. Praktikisht në Janar të vitit 2023 pagat e ujësjellësit të Rrogozhinës janë bërë nga drejtoria rajonale pra nga fondet tona pra jo nga bashkia e Rrogozhinës. Unë kam bërë një ushtrim shumë të thjeshtë për të kuptuar se çfarë pozicioni dhe sa është cmimi që e shesim në këtë m³ ujë. Nuk e di a e keni materialin por do ti bie shumë shkurt.

Mukades Gixhari. Kemi edhe për kanalet një projektvendim përpara.

Erida Hoxha. Unë kam bërë një llogari shumë të shkurtër, kam përfshirë kostot operacionale, m³ kostot operative që janë të dedikuara për të cuar këtë ujë tek shpija e gjithsecilit dhe për cdo të shitur kam nxjerrë koston defakto që kemi sot që flasim. Kosto në metër kub në sektorin e ujësjellësit është 99 lek duhet të jetë 94 lekë faktikisht me tarifën aktuale që kemi, kemi humbje nga 50 lekë për m³ për shitje, ndoshta ka shumë shifra financiare por tabela është shumë e qartë që ne të kemi mundësi jo ta rregullojmë situatën financiare por ta përmirësojmë atë. Ishte e nevojshme bashkë me ndërhyrjen e ministrit dhe sektoriati jonë të bëhen rishikime të tarifave aktuale. Rrogozhina kishte që në 2013 që nuk kishte bërë aplikim tarifash, ka 10 vjet që vazhdo me të njëjtin cmim ku janë rritur kostot e jetesës në të gjitha konceptet, është peshë gjithashtu energjia ajo pjesa e pagës shoqërohet me rritje të kampit të sigurimeve shoqërore etj. Kostot materiale që nga 2019 që ishte tërmeti etje etj kanë pësuar rritje materialet hidraulike, energjitike që janë operative në pjesën e punës. E njëjta gjë vjen edhe për kanalizimet që janë rritur 38 lekë për cdo metër kub të shitur ujë. Po flasim për nivele 170 mijë m³ jo për vlera të vogla. Doja të theksoja dhe të shtoja gjithashtu që në Rrogozhinë më konkretisht nuk po bëhet një ndryshim cmimi sic po bëhet në vende të tjera dhe sektori, kategoria familje kishte 2 nivele cmimesh ne kemi bërë rumbullakime të tyre. Ka nivel cmimi 38 lekë dhe 48 lekë ne kemi bërë një, nuk shkonim dot në obligim sepse është shumë e vështirë ta bësh kaq shpejt sepse ka kosto të ndryshme por kemi propozuar të jetë në nivelin 28 dhe tarifa e shërbimit nga 1 qind lekë të rritet në nivelin 2 qind lekë sepse efektet financiare janë shumë pak më të ndjeshme sesa në njësitë e



tjera. Por edhe në materialin bashkangjitur keni efektet se sa ndryshimi financiarë për cdo faturë do të jetë 1qind lekë për zonën rurale kategoria familje dhe 2 qind lekë për zonë urbane.

Mitat Daja. Pra nga 38 do shkojë 100 apo jo?

Erida Hoxha. Nga 38 shkon 48, aktualisht Rrogozhina vijon me dy cmime, 38 dhe 48. Ndërkohë që në do të mësojmë të bëjmë një unifikim 48 pasi nuk është rritje sepse kjo sot aplikohet vetëm në zonën rurale dhe jo në zonën urbane.

Përfaqsesi Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a. Dhe shërbimi e merr të njëjtë sepse ashtu e ka dhe Lekaj, Gosa të njëjtin shërbim marrin, konsumi i energjisë është i njëjtë.

Indrit Dedei. Doja të thoja dicka kjo shoqëria juaj investimin tani që është mbushur si shoqëri apo para.

Erida Hoxha. Atëherë po ta shpjegoj, ti po flet si rajonal apo si...

Indrit Dedei. Unë po flas për bashkinë Rrogozhinë.

Përfaqsesi Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a. Meqenëse investimet e Rrogozhinës ne kemi marrë investimet që kanë qenë në proces ose kanë përfunduar. Aktualisht ne së bashku me ministrinë e transportit po diskutojmë për pjesën e bregdetit që është pjesë e Spillesë me ujsjellës, kanalizime komplet Kryevidhi, kurse pjesa e Komunës Gosë është duke vazhduar procesin e ujsjellësit dhe në Lekaj. Në Rrogozhinë ka përfunduar komplet, në Ballaj ka përfunduar kurse për pjesën e bregdetit janë hartuar disa projekte të mëparshme që duhen rishikuar në 2016 duhet të jenë hartuar, duhen parë me planin urbanistik si do zhvillohet dhe do përmirësohet ky projekt që të kemi mundësi të marrim fondet për pjesën e kanalizimeve janë fonde që mund të vijnë edhe nga donatorë të huaj mund të jetë grand 80%, 20% është investimi mund të jetë kredi që mund ta marrë shoqëria jonë ose rajonale ose mund të jetë edhe nga buxheti i shtetit që mund të jetë dhe 20 %

Indrit Dedei. Nuk është problemi aty ato spo sjellin taksat. Po i rrite cmimin...

Përfaqsesi Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a. Nuk është rritje cmimi ky është minimumi kyc 10 lekë si e merr ai në Gosë, në Lekaj pse ai në Lekaj e merr 48 lekë dhe ai në Gosë 38.

Indrit Dedei. Këtu mund të ngresh kujdesin përgjegjës...

Erida Hoxha. Është rritur kostoja e jetësës jemi koshientë të gjithë kjo është absolute fare, jeta



që pas covidit, tërmetit në mënyrë të padiskutueshme është rritur jetesa

Hekuran Xhani. Kostoja e jetës është rritur por nuk e di mirëqenia?

Erida Hoxha. Është ulur mirëqenia.

Hekuran Xhani. Epo kjo gjë të rritet kostoja të ulet mirëqenia.

Erida Hoxha. Kjo është shkak pasojë, po flasim në 2013 që ka qenë një pagë që ka qenë e pa deklaruar fare dhe ka qenë e nivelit 16 sot nuk ka pagë minimale pa 40 mij lek që ke kushte nga shteti.

Indrit Dedei. 370 mij lekë mer një polic bashkiak 270, 280.

Erida Hoxha. Atë nuk e vendos unë ka strukturë organike.

Indrit Dedei. Atëherë kjo është jetesa.

Erind Tosku. Mund të bëj një pyetje, atëherë me këto tarifa që ne do rrisim dhe me këto borxhe të akumuluar që nuk paguajmë dot punonjësit del ajo që paguhet borxhi apo punonjësi?

Erida Hoxha. Punonjësi aktualisht mbulohet nga shoqëria rajonale, sot që flasim shoqëria rajonale ka marrë që ta cojë përpara është në proces.

Erind Tosku. Gosa, Lekaj, Sinaballaj se besoj se ka përfunduar akoma, rrjeti jo. Në qoftë se e nisim sot ta bëjmë 48 lekë në Lekaj, Gosë dhe Sinaballaj që nuk do të përfundojë lidhja me rrjetin, do paguajnë po 48 apo ...

Erida Hoxha. Do paguajnë po 48 me të njëjtin cmim që është absolut.

Erind Tosku. Sepse ato nuk kanë përfunduar janë me rrjetin e vjetër dhe kanë probleme me orarin, me cilësinë e ujit me infrastrukturën me probleme që janë mbartur dhe vazhdojnë të mbarten, domethënë është e drejtë kjo pjesë për qytetarët që nukm ka përfunduar e gjithë?

Erida Hoxha. E kuptoj pjesën, sepse dhe unë jam qytetare vetë nuk do të më pëlqejë në plan të parë që do të rritet cmimi por ka shumë arsyeje.

Erind Tosku. Nuk jam kundër rritjes së cmimit e kam për këtë kategori që nuk kanë, vazhdojnë me ujin e vjetër me tubat prej 40 vjetësh.



Erida Hoxha. Ka dhe dicka tjetër, ne nuk jemi vetëm kemi edhe mbikqyrës lart që është katalizatorë midis nesh dhe qytetarëve pra nuk mund të bëjmë dot 2-3 fasha cmimesh sepse sot është problemi këtu por nesër mund të jetë në një zonë tjetër që ka aktualisht cmim të lartë mund të themi tek 48 dhe do bëjmë një pausë dhe ne shkojmë në unifikim dhe jo në fasha të ndryshme cmimesh. Sot Endi kërkon që për të gjitha njësitë ta ketë cmimin 70 lekë sa është në Durrës por nuk e bëjmë dot se ti bie lapsit e kam shumë të thjeshtë ndërkohë që ne kemi 4 njësi dhe jemi munduar të bëjmë llogaritje me këmbë në tokë për të parë kostot. Kostot që ka Durrësi nuk i ka Rrogozhina absolutisht por Rrogozhina mbulon dhe sigurimet. Synimi i realizimit është mirë sigurimi i menaxhimit dhe të sjelli të ardhura jo të thellojë borxhet me shumë.

Mukades Gixhari. Zoti Sokol Gosa.

Sokol Gosa. E mira do të ishte që këtë diskutim për rritje apo ulje të bëhej kur të kishte përfunduar rrjeti kompjut, nuk e di për punët që janë bërë nga ju apo nga dikush tjetër them sepse punët janë skandaloze, që nga tubat, shtrimet mbulimet e të tjera me rradhë. Nuk ka lagje që nuk u kanë plasur ujërat, nuk ka mbetur rrugë apo rrugicë pa plasur prandaj të bëni këtë diskutim nga afër për mua nuk ia vlen. Të mbarojnë punimet, rrjedha ujsjellësit me standarte e të gjitha se janë hedhur miliarda lekë, të bëhen këto punime kjo është tallje tallje për bashkinë që ju vini sot dhe kërkonit tarifa. Jo nuk jam të bëhet nga e para të rregullohet të përmisohet të bëhet me standarte atëherë vini të diskutoni për tarifa, nuk jam dakort me këtë. Punime janë skandaloze nuk e di a janë marrë në dorëzim apo jo? Jo fare.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a . Ok dakort shumë e drejtë, nga informacionet e marra për investimet , nga Rrogozhina nuk kemi marrë asnjë informacion. Nga agjensia financuese kemi pesë investime, nga të cilat tre janë të përfunduara po flasim nga 2019-2023 dhe dy janë në proces. Të pesta kontratat kanë indikatorë bashkinë jo ujsjellësin Rrogozhinë që do të thotë ne drejtori rajonale i marim në dorëzim pasi i merr bashkia. Ne po flasim për pesë investime, funksioni i rrjetit të brendëm në Rrogozhinë që është i përfunduar, rikonstruksion i kanalizimit në lagjen Gosë i përfunduar.

Sokol Gosa. Nuk është e vërtetë.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a . Janë marrë në dorëzim nga bashkia dhe nga ujsjellësi.

Sokol Gosa. Të ketë marrë bashkia në dorëzim ato punime kjo është shkelje shumë e rëndë.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Në njësinë Sinaballaj kemi marrë edhe ne



dorëzim, flasim për dy investime që janë në proces e sipër dhe nuk është marrë asgjë në dorëzim dhe ne presim që të përfundohet dhe pastaj ne marrim pjesën tonë po gjithsesi po ke shumë të drejtë. Ne ofrojmë shërbim dhe për shërbimin që ofrojmë duhet të shikojmë tarifën nuk po bëjmë rritje tarife ne po bëjmë unifikim tarife dhe është e vetmja njësi dhe i di problematikat që ka dhe për ne është shumë e vështirë nga ana teknike ta menaxhojmë, kemi patur problematika, mjete, pajisje vijnë nga Durrësi për ti mirëmbajtur por zona është shumë e gjerë. Si informacion ne vetëm si zonë e Durrësit jemi shumë e gjerë, shtojmë edhe Kavajën, Rrogozhinën dhe Krujën dhe jemi një zonë shumë e madhe për të menaxhuar. Nuk po themi se duhet të marrim ti bëjmë në qafë qytetarëve të Rrogozhinës dhe të marrim tarifë më të madhe, ne duam që të bëjmë...

Sokol Gosa. Zonjë informacion po jap në cdo lagje të qytetit apo në xhade janë carë tubacionet, do ti jap me fakte tani do ti sjell me foto. Është një banore aty afër ku nuk del dot se kanë plasur tubacionet.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Ne kemi grupe pune që bëjnë mirëmbajtje dhe bëjmë për aq sa kemi mundësi ne bëjmë.

Sokol Gosa. Ajo nuk ka nevojë për mirëmbajtje, duhet cdo gjë nga e para. E ke parë cfarë tubash janë futur aty, cilësia se janë marrë ku janë marrë ato lloje tubash. Pse të vuajë ky brez pse të vuajnë fëmijët tanë është investim që bëhet një herë në 40 vite nuk bëhet cdo vit, fondet kanë qenë miliarda.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Tani ne po flasim se cfarë do bëjmë sepse cfarë është bërë.

Sokol Gosa. Absolutisht jo.

Mitat Daja. Ju po e bëni fakt të kryer po fakti i kryer nuk bëhet kështu. E para punës jeni mësuar me këto situata shumë e keqe situata shumë e keq, situata e keqe ka ndodhur për një mijë arsyeje hiq një drejtor, një nënpunës paguaj një drejtor që punon një që rrinë shtëpi, paguaj punëtorin që punon dhe punëtorin që rrinë në shpi dhe kjo është situata. Pyetja që unë bëj, raporti abonenë dhe tarifë mbulon ndonjë shpenzim apo sa është përqindja e mbledhjes së tyre nëse Rrogozhina është 95% e pagesave pse duhet të bëhet kjo punë? Mbështes edhe kolegun investimi që është bërë nga tubacionet është më skandaloz, nuk e di ato që e kanë marrë në dorëzim se di ca logjike kanë patur, ose nuk jetojnë fare në Rrogozhinë.

Geraldo Gjini. Ta shpjegoj.

Mitat Daja. Edhe në qoftë se e ke marrë ti në dorëzim e ke gabim, se te shpia ime kur kalon nuk



ke as kanalizime të ujrave të zeza, paguajmë tarifa ne në rregull. Paguajmë tarifa dhe ska kanalizime akoma, ska projekte akoma dhe ujrata e zeza bashkohen me tubacionet e cezmave në rregull ë? Pasi të jepni përgjësime këtyre që i kanë bërë dëm shtetit ti conit atje ku është për ti cuar pastaj mbledhemi këty kërkime tarifë tjetër, nuk e fus as në shqyrtim këtë.

Renato Kalem. Dy pyetje maksimumi doja të dija si informacion sa përqind është niveli i ndërtimeve në bashkinë e Rrogozhinës, niveli i të ardhurave se nga këtu nis problemi sepse neve nëse nuk mbledhim lekë ky është problemi kryesorë i joni, mbase po të mbledhim më shumë të ardhura. Pyetja dytë bashki si puna e Rrogozhinës të ngjashme të vogla sa e kanë pagesën e ujit të bëjmë një krahasim, jo krahasim me Tiranën Durrësin? Treta tek pika 10 ke thënë dhënien e opinionit që duhet të japi këshilli bashkiak, tani sa rëndësi ka ky opinion për dhënien e kësaj ne vendosim të themi jo nuk është e domosdoshme a bëhet rritja apo jo?

Erida Hoxha. Do rritet. Kjo ka një protokoll pra ne sot aktualisht kemi marrë vetëm këshillin të mbikqyrës dhe kjo është procedurë protokollit që ka gjithsecili të drejtë të shprehë mendimin e tij. Sa për pyetjet arkëtimi dhe shitja janë gjëra të ndryshme, arkëtimi është keshi ne synimin e kemi te shitja, shitja është e ardhura shitja është leku dhe llogaritë bëje vetë sa përqind zë arkëtimi i Rrogozhinës në gjithë këtë në këtë që po flasim besoj se përgjigjet e morët.

Indrit Dedei. Sa muaj ka që është formuar në Shqipëri?

Erida Hoxha. Qytetaria tregtarisht ka filluar aktivitetin më 01.01.2023.

Indrit Dedei. Sa punëtorë ka futur në punë ajo ka shoqëria juaj 2-3 muaj para zgjedhjeve? Ka dosje kjo se në qoftë se ka punëtorë dhe janë hequr pas zgjedhjeve i bie...

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Unë kam dy muaj që jam caktuar nga shoqëria si kordinatorë në Rrogozhinë.

Indrit Dedei. Ka punëtorë që kanë ikur nga puna pas zgjedhjeve, tani se di...

Erida Hoxha. Atëherë ne po flasim këtu për shifra jo iku punonjësi, do dali në pension X do zëvendësohet me Y.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Është e vetmja shoqëri që numrin e punonjësve e ka në strukturë dhe cdo njeri ka pozicionin e vetë, mandje mund të ketë për shtim kapaciteti të punonjësve sepse për pjesën e mirmbajtjes që thotë zotëria janë katër veta në të gjithë Rrogozhinën janë katër veta kështu që...



Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Tha dicka për tarifën zotëria për bashkitë e vogla? Së pari nga ju presim një mendim procedura e rrugës është e tillë ne bëjmë procedurën e miratojmë tek këshilli jonë dhe e cojmë në bashki për miratim por për mendim ne nuk jemi këtu për të marrë miratimet tuaja ne po marrim mendim jeni pro, kundër duam një mendim dhe këtë mendim e kërkon AKU.

Mitat Daja. Ne jemi kundra.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.. Së dyti në lidhje me bashkitë e vogla po flas unë e kam listën e tarifave, nuk ka lidhje bashki e vogël e madhe ka lidhje kosto e prodhimit të ujit nëse e keni për ujin këtu jasht 70% e ujit janë në rrjedhje nuk ka lidhje Rrogozhina apo Durrësi ne e kemi kërkuar sepse kemi kosto 80% energji elektrike. Ne kemi këtë lloj tarife, 70 lekë për m³ e ka dhe...

Indrit Dedei. Ka dy pompa.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Jo dy pompa si thua ti kemi dy pompa kemi 3 stacione.

Indrit Dedei. Uji është në tokën tonë, ju e merrni nga Lushnja.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Jo nuk ka lidhje me Cermën ne furnizojmë një lagje të Durrësit, nuk ka lidhje ne marrim nga Fushë-Kruja.

Indrit Dedei. Jo se vjen nga Lushnja plazhi.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Jo nuk ka lidhje plazhi është një lagje e Durrësit. Po flasim për Peqinin që është pothuajse është bashki e vogël e ka 70 m³, flasim për kosto prodhimi uji sa larg është burimi nga stacioni sepse sa më aq aq më shumë humbje teknike ke. Janë shumë faktorë, AKU ne propozojmë tarifat tek AKU dhe ajo i merr vendimet.

Erind Tosku. A të bëj një pyetje? A jeni në dijeni që ka ende tuba të ujsjellësit të Rrogozhinës dhe bëjnë kalimin e masave gjatë polorimit a jeni në dijeni, mos justifikoj anën teknike se këtë anën e shmangies së pyetjes...

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Nuk jam e sektorit të shitjes.

Erind Tosku. Jo shitjes, nga ana teknike a jeni në dijeni a mund ta udhëzimin në raport me cmimin dhe masat e abonentit. Indrit 1 minutë që të jemi të qartë, para se të vijë uji sjell ajër apo



jo?

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Po

Erind Tosku. Sahati ecën apo jo, ecën.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Nëse është montuar sipas lartësisë së duhur...

Erind Tosku. Sduhet të ketë ajër, teknikisht, shkencërisht nuk duhet të ketë ajër?

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Jo sduhet të ketë.

Erind Tosku. Ka ajër gjithsesi, po të jap dijeni që ku është defekt teknik që ta shikoni nga ana e shoqërisë tuaj.

Mukades Gixhari. Po, zoti Enver

Enver Memolla. Përsa i përket kësaj pjesës teknike B. Memolla një mik që ka 100 m³ atje lart sepse unë jam banorë i asaj lagjeje, aty mungon tubacioni ku e keni?

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. E kam parë si problem është ajo linja e gjatë dhe e kemi zgjidhur ka 3 javë 4 javë por prap ka probleme me presionin.

Enver Memolla. Para 10-12 ditësh e kam matur unë 13minuta e 45 sekonda ajër.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Ashtu është bërë zgjidhja...

Enver Memolla. Në kat të dytë ka presion në kat të dytë në depozitë i shkon uji.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Aty e ka pozicionuar projektuesi që e ka bërë, jemi përpara këtij fakti.

Enver Memolla. Atëherë ne këtë fakt si do e zgjidhim.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Atëherë për këtë jemi të diskutojmë.

Erind Tosku. Përderisa po bëhet diskutimi vendimin e keni marrë.



Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Vendimin e mer ERRU.

Shpati Kolgega.Procesi i transferimit që të jemi të gjirhë koshient ka qenë ka qenë një proces i menaxhuar nga ne dhe pika ku është tani po flasim për menaxhimin tonë, bashkisë tonë partisë tonë, partisë që ishte më para. Investimi i bërë tani ka qenë pjesë e epokës së ujsjellësve që ka qenë në menaxhim të bashkisë tani është për punë shoqërire e cila besoj se do të ketë përgjësi të reja, investime për mirmbajtje etj me rradhë. Për këtë pjesën nuk e di çfarë do të ndodhi me këtë pjesë është bërë një investim dhe është bërë si mos më keq sipas këshilltarëve. Çfarë ndodh tani e mbrapa në qoftë se do të bëhen investime të reja, mirëmbajtje të reja, në qoftë se do të punësohen njerëz të rinj se mund të ketë patur edhe njerëz jo të aftë. Çfarë do të ndodhi tani e në vazhdim që e kemi marrë ju në dorë tagrin.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Ne e kemi treguar veten edhe këto muaj, puna e parë që kemi bërë është që kemi shkuar, vumë në punë rrjetin e ri që diskutuam, doli stacioni pompa që është në Rrogozhinë. Kemi ulur koston e energjisë, kemi bërë njoftimin e territoreve kemi 3-4 muaj që kemi mundur dhe po mbledhim debi të vjetra që kanë qenë të akumuluar gjatë gjithë kohës. Për pjesën e bizneseve kemi ,marrëveshje sepse kanë bërë gjithë pagesën gjithë shum e debisë që kanë patur, për kontratat e reja jemi në hapat në qytet për shembull ka shumë zona ose lagje që nuk kanë kontrata që ka shkuar një njeri dhe nuk është shfaqur asnjë lloj interesi ndaj qytetarëve, jemi duke punuar me aq kapacitet që kemi të zonë ato punëtorë që janë këtu ka filluar dhe ka lëvizur e shikoj edhe me punën që ka lëvizur. Për pjesën e projekteve këto projekte që janë në proces në bashkëpunim edhe me bashkinë sepse këto janë investime të shtetit por që ka qenë bashkia Rrogozhinë dhe ne jemi si të jashtëm në këtë proces. Kemi kërkuar gjatë gjithë kohën informacion, këto investime të mbyllen sa më shpejt. Kemi bërë investime me bashkinë edhe me firmat që të vihen në proces të përmirësohet cilësia e shërbimeve në këto zona, zona e Lekaj dhe zona e Gosës. Këto problematikat e qytetit i kemi shfaqur ia kemi shfaqur AKU që ka qenë investitorë i këtij qyteti, të gjithë problematikat i kemi shfaqur dhe presim një përgjigje se ky është një investim që në qoftë se do rishikohet skema ose aty ku ne kemi bërë tender sic është ajo pjesa aty e lagjes, do shikohet të gjendet një zgjidhje por kjo zgjidhje ka një kosto. Ne tani aktualisht po monitorojmë gjendjen ekzistuese, në momentin që do të veprojmë atëherë... Kjo është gjendje aktualisht që ne e kemi marrë domethënë, nuk është vetëm bashkia Rrogozhinë në këtë gjendje ose edhe më keq është bashkia e Krujës, Kavajës, Shijakut apo edhe Durrësi por Durrësi ka patur një problematikë por kemi qenë ne dhe i kemi ndjekur ne ka patur investime të 2003 i jemi kthyer prap si rezultat i cilësisë së dobët së materialit.

Mukades Gixhari. Zoti Enver po.

Zoti Enver. Të lutem Mitat të vazhdoj pak.



Mitat Daja. Po shqetësohem për vetë faktin si nuk shkonka tek depozika në katë të dytë.

Zoti Enver. Atëherë në lidhje me kontratat e reja që po bëhen nga banesat që nuk janë legalizuar do të thotë që ka banorë që i cojnë ASHK një kërkesë për të marrë vendim që është në legalizim, po banorët që nuk janë në proces legalizimi çfarë ndodh?

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Tani ne këtë gjë e kemi jo vetëm tek ju por edhe tek bashkitë e tjera sic është bashkia Shijakut... Ne këtë e zgjidhim duke dhënë bashkia vetë një vërtetim vetë, edhe punonjës tonë të shërbimit të klientit i kemi paraqitur një vërtetim të ngjashëm sic e lëshon bashkia Shijakut. Është një vërtetim fakti që këtë gjë ju mund ta keni përdorur edhe gjatë procesit të rindërtimit, që jepet nga ana e bashkisë që tregon që zoti Lorenc është banues i zonës me këtë ndërtesë dhe këtë numër kadastral pasurie. Dhe ne me këtë vërtetim ia kemi lidhur kontratën sepse ne procedurën e lidhjes së kontratës e kemi të miratuar nga bordi dhe nga AKU që duhet të ketë këto dokumentacione por duke qenë se ky është një vërtetim që e lëshon institucioni lokal ne e kemi pranuar si dokument pronësie sepse nesër pasnesër ne si institucion jemi të mbrojtur sepse ky dokument është i lëshuar nga ana e bashkisë, nuk është një vërtetim dore që lëshohet nga...

Enver Memolla. Edhe dicka, përse i përket linjës së re a keni ndonjë përqindje sa janë rikuperuar?

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Në qytet janë rikuperuar shumë ka qenë diku tek 60%.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Jo Rrogozhina 78%, 68% ka qenë këtë muaj totali.

Erver Memolla. Humbje në rrjet?

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Po totali se ne në fakt janë dy lloje humbjesh që llogarisim domethënë...

Enver Memolla. Pyetjen ta bëra në lidhje se çfarë keni marrë si produkt.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Ka patur dmth në muajin Gusht goxha por akoma nuk kemi bërë një raport...

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Duhet bilanci që të dish se sa futet në rrjet dhe e bën të saktë pastaj. Po po.



Enver Memolla. Se në bazë të udhëzimeve që kemi del sasia e ujit dhe pastaj i bie del debi.

Silvana Aliu. Në momentin që ti kërkon një vërtetim nga bashkia duan e japin duan nuk e japin si funksionon? Në momentin unë si klient paraqes ty një librezë që po bëj energjinë elektrike.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Nuk e pranon, nuk pranohet.

Silvana Aliu. Epo bashkia stë presin.

Përfaqësuesi e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Nuk pranohet, kjo gjë

Geraldo Gjini. Në moment që janë shlyrë taksat nuk ke asnjë pengesë e vetmja pengesë mund të jenë taksat.

Silvana Aliu. Po këto banesa që bashkia nuk i ka fare.

Geraldo Gjini. Bëhet me kryeplakun, shkon kryeplaku.

Silvana Aliu. Dilni në terren, bëni atë regjistrimin e banesave.

Mitat Daja. Mbaruat.

Shpati Kolgege. Kemi pikën e fundit.

Mitat Daja. Pika fundit është më e rëndësishme.

Mukades Gixhari. E hedhim në votim?

Indrit Dedei. Është punë kështu kjo, ata nuk kanë ardhur kot ose ta kalojmë ose të...

Mukades Gixhari. Kush është Pro në miratimin e tarifave, kush është Pro?

Mitat Daja. Për çfarë zysh?

Mukades Gixhari. Për miratimin e tarifave. Pro, Abstenim?

Shpati Kolgega. Unë do të ndërhyja me Abstenimin që kësaj shoqërië të re ti japim një mundësi të tregojë menaxhimin meqënëse tani e ka marrë në dorë dhe mbase në një moment të dytë të kërkohet një miratim. Kam në dorë prova që ju do të menaxhoni si duhet me menaxhuar dhe



patjetër ta cojmë koston atje ku duhet të planifikojmë dhe të ecim përpara sepse kështu do të ecim përpara. Por të ju japim mundësi edhe juve duke Abstenuar sot dhe pas një mbledhje ose disa kur ta shohim të arsyeshme.

Mitat Daja. Cdo gjë tani ndryshon nuk është e thënë që është fiks cdo gjë ato ndryshojnë.

Shpati Kolgega. Dhe pastaj japim një mundësi pse jo, një unifikim për të përmirësuar të gjithë shërbimin.

Erida Hoxha. Nëse do të kishit mundësi të pyesnit një punonjës që punon në Rrogozhinë atëherë pagën cdo muaj e merr e con tek shtëpia, nqs thotë jo unë këto letrat i marr mbrapsh sepse ne fund të ditës gjithë qëllimi është që të marrim një pagë, është mirëqenie për të gjithë dhe pastaj ka një mijë arsye të tjera, flasim nga ana njerëzore e para.

Sokol Gosa. Tani këto llojin e presionit gjej dikë tjetër ta bësh unë problemet e mia i parashtrova dhe pata mbështetjen e 99% këtu , duhet të vendosim tulla tani kur kalojmë ka më argument se ky dhe ne ta kalojmë ta miratojmë. Unë e miratoj i pari në qoftë se ju si shoqëri e keni marrë në dorëzim keni bërë rregullimet e duhura, ndërhyrjet e duhura dhe që ka ardh ardh uji nëpër banesa.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Doja të pyesja asnjëri nuk keni ujë në shtëpi sot me çfarë furnizoheni?

Sokol Gosa. E kemi me orar.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. E kemi me orar, edhe ne ne Durrës me orar e kemi është e njëjta gjë.

Sokol Gosa. Thash për punën e kanalizimeve.

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Në rregull, kanalizimet janë shumë problem.

Sokol Gosa. Rregolloni këto sistemojeni dhe jam unë me dy duar...

Përfaqësuesja e Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh. Janë investime që...

Sokol Gosa. Jo, jo unë nuk jam për vete nuk e di.



Mukades Gixhari. Atëherë Pro, Kundra, Abstenim? Kundra 7, Abstenim

Hekuran Xhani. Njësoj janë si Absteni si Kundër ne kërkojmë thjeshtë rehabilitim, shërbim.

Mukades Gixhari. Kemi dhe të ndryshme.

-Miratohet pika 14 e rendit të ditës, për dhënien e opinionit me 0 vota pro, 7 kundër, 6 abstenim mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a me Nr.4244.Prot datë 28.08.2023” dhe sipas projekt-vendimit të propozimit nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3347.Prot datë 19.09.2023

Vendim nr.24. Miratohet dhënia e opinionit me 0 vota pro, 7 kundër, 0 abstenim mbi propozimin nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.3347.Prot datë 19.09.2023 “Për dhënien e opinionit mbi propozimin për planin e ri tarifor për Ujësjellësin Rrogozhinë sipas shkresës së Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a me Nr.4244.Prot datë 28.08.2023”.

Mitat Daja. Atëherë është bërë një diskutim herën që shkoi për punën e arsimit dhe drejtori i arsimit nuk ka ardhur. Ju lutem herën tjetër të vijë sepse duam të diskutojmë për problemet që ne i shohim tek arsimi. Tjetër gjë kanë ndodhur situata zjarresh në disa vende dhe normalisht sot këtu duhet të ishte drejtori i emergjencave civile të bashkisë për të sjellë një informacion cfarë dëmsh janë bërë sepse ka njerëz që janë dëmtuar dhe mund të jenë votuesit e mi, juaj dhe kanë probleme. Duhet të ishte drejtori i emergjencave civile dhe të jepte informacion se cfarë ka ndodhur, sa dëme janë bërë dhe si mund ti ndihmojmë këta njerëz. Kjo duhet të ishte bërë, herën tjetër duhet të vijë dhe të japë informacion të na drejtojë dhe ne se cmund ti bëjmë këtyre njerëzve. Këto dy gjëra kisha unë.

Enver Memolla. Dua të ngre një pikë përsa i përket mbledhjes së këshillit jashtë radhe, sic ishte ajo e datës 6, zonja kryetare në rregullore thuhet se letrat e këshillit dhe propozimet me shkresë duhet të bëjnë mbledhjen e këshillit jashtë radhe cka do të thotë që kryetari i grupeve duhet të jetë dhe të bëhet mbledhja e kryetari të grupeve për të vendosur mbledhjen e këshillit bashkiak dhe me sa kam dijeni unë si kryetar grupi nuk kam kërkesë zyrtare nga kryetarja e këshillit bashkiak, nuk kam kërkesë zyrtare për mbledhjen e grupit që përcillet nga kryetarja e këshillit, kështu që herë tjetër të mos e bëjmë të prezedentë këtë pjesë të lutem zbato rregulloren.

Mitat Daja. Domethënë nuk lejohet të kërkohe mbledhje jashtë radhe për raste emergjente?

Enver Memolla. Ke të drejtë me shkrim unë si kryetar grupi, me shkresë zyrtare e ke zoti Mitat 1/3 e anëtarëve të këshillit bashkiak i drejtohet kryetares.



Mitat Daja. Po ti lexosh mesazhet në grup...

Enver Memolla. Ky mesazh këtu nuk është zyrtarisht dhe unë në mënyrë zyrtare nuk jam informuar

Mitat Daja. Nuk je informuar? Ju thjesht bëni interesantët sepse cdo gjë e trajtoni kështu.

Silvana Aliu. Nëse do ndjekim gjithmonë këtë rregull që thua ti atëherë ne nuk mund të bëjmë asnjëherë mbledhje.

Enver Memolla. Po mund të bëni mbledhje.

Silvana Aliu. Sepse mbledhjet e këshillit deri tani i ka bërë opozita, ju 3 vetë ka vetë keni ardhur. Atëherë atë ditë ju nuk respektuat opozitën sepse ishte kërkesë e opozitës dhe ju nuk e respektuat aq më tepër që 4 mësues nga ju nuk erdhën.

Mitat Daja. Kur do e bësh mbledhjen ti pasi ka filluar shkolla dhe do diskutosh problemet e shkollës.

Enver Memolla. Unë po i drejtohem kryetares pse unë dhe kjo pjesë nuk është bërë, ke një rregullore të këshillit bashkiak dhe duhet zbatuar.

Mitat Daja. Ja anulloje mbledhjen që bëmë tani ti, e hedhim votim.

Mukades Gixhari. Zonja Silvana.

Silvana Aliu. Në tre mbledhje kemi kërkuar përgjegjësin e arsimit për këshillin bashkiak.

Mukades Gixhari. E ke fjalën për përgjegjësin e arsimit të bashkisë, zotin Fatmir? Përgjegjesi është Arben Daja dhe drejtori Fatmir Mece.

Silvana Aliu. Drejtori, herën e parë na foli për performancën, na foli me arrogancë e të gjitha tani a mundet zoti Fatmir të na japi një përgjigje për një edukatore që është lëvizur në bashkinë e Rrogozhinës? Me çfarë të drejte, edhe sikur të kishte marrë drejtimin e fushatës është drejtoreshë e kopshtit ulet bëhet edukatore por ta heqësh dhe ta cosh ne nje vend të papërshtatshëm aq më tepër ku nuk kishte fëmijë, nesër pasnesër këtij personi me i shkuar kontroll del që ska numër fëmijësh dhe ik... Tani të vijë drejtori të japi përgjigje se për çfarë arsyeje është hequr.



Mitat Daja. Pse është shkarkuar një drejtoreshë kopshti?

Silvana Daja. Dhe performancën nëse e don ai, performancën që ka bërë ajo se ka bërë njeri.

Indrit Dedei. Gjeji vendin në qoftë se nuk ka vend aty coje ku ke bosh jo ta cosh 7 kalamaj dhe 2 edukatore sikur nuk shkon. Kryetari bashkisë bën çfarë të dojë, se problemi është Fatmir Mece kryetar arsimit është ai dhe është marrë me fushatë apo puntori tjetër që deklaroi që ka 4 muaj që merret me fushatë.

Mukades Gixhari. Po patjetër, mbledhjen e rradhës do të vijë të relatojë personi përgjegjës, për sot nuk e kishim këtë pikë në rend të ditës, meqënëse e ngrijti Silvana mbledhjen e rradhës patjetër që do ta thërrasim apo njoftojmë.

Mitat Daja. Edhe drejtorin e gjendjes civile që të ketë një informacion.

Mukades Gixhari. Patjetër.

Hekuran Xhani. Rregulloren e bazuar në ligj e miraton këshilli dhe kur e miraton këshilli është e detyruar të zbatohet nga të gjithë këshilltarët. Po kjo rregullore unë nuk di të jetë bërë rregullore e re ndoshta ju mund ta keni po kjo rregullore duhet dorëzuar sekretarit dhe gjithë këshilltarëve se na tha dhe kordinatorja zvicërijane që po bëjmë rregulloren për qeverisjen vendore bazuar edhe në standartet Europiane po na ndihmoi edhe ajo me standartet e reja në jemi dakort. Rregullorja duhet të jetë praktikë e qartë e cdo këshilltari, për mbledhjet jashtë radhe unë në njohje dhe zbatimin e ligjit të takon ty, Indrit Dedeit mblidhuni paraprakisht konsultohuni për rendin e ditës që do të vendosni dhe drejtohuni me shkrim kryetares dhe kryetarja dhe kryetarja pastaj procedon. Është kompetencë e juaja.

Mukades Gixhari. Do të zbatojmë ligjin.

Enver Memolla. Për të qenë një këshill taman duhet të bëjmë sic u tha në këtu për ato që na kanë votuar jashtë.

Indrit Dedei. Kryetarja është jashtë ligjit, është kryetarja është e të gjithë këshillit por është direkt pas kryetarit të bashkisë kryetarja e këshillit bashkiak për fuqinë.

Enver Memolla. Clidhje ka kryetari i bashkisë.

Indrit Dedei. Është kryetarja e këshillit bashkiak dhe për komisionet është...



Enver Memolla. Po pra po atë po them unë. Unë dje tek Komisioni i Ekonomisë propozova dicka ia thashë edhe Barazitit dje se është pjesë e komisionit të ekonomisë, komisionet ne do i nisim të mos bëhemi të pambledhshëm.

Mukades Gixhari. Fleksibël i lëvizshëm mund ta ndryshoni ju.

Enver Memolla. Nëse nuk mblidhet komisioni cdo kryetar i cdo komisioni bën propozim për zëvendësim komisioni, ato që mblidhen.

Mukades Gixhari. E mbaruam diskutimin të nderuar këshilltarë meqë cdo gjë e trajtuam sot.

Mukades Gixhari . Mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur. Faleminderit.

-Këshilltarët përshëndesin njëri tjetrin.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 17 : 50^{oo} . (Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati në total 02 orë ; 44 min ; 56 sek).

- Ky procesverbal mbyllet në faqen 58 (pesëdhjetë e tetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera

